




Të drejtat e rezervuara për Agjencinë Kosovare të Pronës, (KPA), 2010.

Materialet e këtij publikimi mund të ripërdoren me kusht që të përmendet burimi kryesor i tyre.

Agjencia Kosovare e Pronës
Perandori Justinian 5
Prishtinë/Pristina

Telefoni: +381 38 249 918
Telefax: +381 38 249 919
E-mail: mailbox@kpaonline.org
<http://www.kpaonline.org>



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Perandori Justinian 5 - Prishtinë/Pristina
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NË MBROJTJE TË PRONËS PRIVATE – PROTECTING PRIVATE PROPERTY – ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

RAPORTI VJETOR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRONËS PËR VITIN 2009

e themeluar nga rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 - established by UNMIK Regulation 2006/10 - osnovana pod UNMIK Uredbom 2006/10
e përkrahur nga - supported by - podržavaju



PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave
Parathënie

1. Agjencia Kosovare e Pronës

- 1.1 Themelimi dhe mandati
- 1.2 Struktura Organizative
 - 1.2.1 Sekretaria Ekzekutive
 - 1.2.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
 - 1.2.3 Bordi Mbikëqyrës

2. Pranimi i Kërkesave dhe Informimi i Palëve

- 2.1 Statistikat mbi numrin e kërkesave të regjistruara
- 2.2 Notifikimi i kërkesave
- 2.3 Publikimi i kërkesave

3. Përpunimi i Kërkesave

- 3.1 Hetimi i kërkesave
- 3.2 Qasja në të dhënat pronësore dhe verifikimi i dokumenteve
- 3.3 Hartimi i parashtrësive ligjore mbi kërkesat

4. Vendimmarrja mbi kërkesat nga ana e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

- 4.1 Natyra e kërkesave të vendosura
- 4.2 Statistikat mbi kërkesat e vendosura
- 4.3 Procedurat e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
- 4.4 Natyra e vendimeve
- 4.5 Forma e Vendimeve
- 4.6 Urdhërat dhe Mjetet Ligjore

5. Zbatimi

- 5.1 Hyrje
- 5.2 Shpërndarja dhe Zbatimi i Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
- 5.3 Zbatimi i Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
- 5.4 Zbatimi i vendimeve në pritje të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
- 5.5 Mbështetja e Policisë së Kosovës në Aktivitetet e Zbatimit të AKP-së
- 5.6 Zbatimi i Skemës për Kompensim
- 5.7 Mbyllja e Rasteve

6. Administrimi i Pronave dhe Skema e Qiradhënies Vullnetare

- 6.1 Administrimi i Pronave Banesore
- 6.2 Skema e Qiradhënies Vullnetare
 - 6.2.1 Lloji dhe numri i pronave në Skemën e Qiradhënies
 - 6.2.2 Zbatimi i Skemës së Qiradhënies

7. Personeli dhe Aftësimi Profesional

- 7.1 Burimet Njerëzore
- 7.2 Menaxhmenti dhe Personeli

8. Financimi dhe Buxheti

- 8.1 Financimi
- 8.2 Zbatimi i Buxheti

9. Veprimtaritë Informative dhe Shpërndarja e Informatave për Publikun

- 9.1 Transparenca dhe Informimi
- 9.2 Bashkëpunimi në mes Agjencive

10. Ngjarjet kryesore gjatë vitit 2009

ANEKSET

- A. Pasqyra e Rrjedhës së Përpunimit të Kërkesave
- B. Statistikat mbi Vendimmarrjen e Kërkesave
- C. Buxheti i AKP-së për vitin 2009
- D. Buxheti i ndryshuar i AKP-së për vitin 2009 pas rishikimit të buxhetit të gjashtëmuorit të parë
- E. Pasqyra e shpenzimeve të buxhetit të AKP-së për vitin 2009
- F. Pronat nën Administrimin e AKP-së sipas regjioneve dhe komunave
- G. Organogrami i AKP-së

LISTA E SHKURTESAVE

NJPK	Njësi për Përpunimin e Kërkesave
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
ABF	Anëtar i Bashkësisë Familjare
DÇPB	Drejtorati për Çështje Pronësore Banesore
KKPB	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PZH	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
KKPK	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
Autorizim	Autorizim
BDP	Bartësi i së Drejtës Proësore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administrim në Kosovë
UNOPS	Zyre e Kombeve të Bashkuara për Shërbim Projektësh

PARATHËNIE

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor për vitin 2009 të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP). Megjithatë periodha kohore, e cila përfshihej në raportin e vitit 2008 kishte shënuar disa paqartësi politike, kjo nuk kishte ndikuar shumë në produktivitetin dhe funksionimin e AKP-së. Më 31 dhjetor 2008 ka përfunduar efekti ligjor i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe tani Ligji i Kosovës 03/L-079 është legjislacioni i vetëm në të cilin mbështetet AKP-ja, dhe AKP-ja tani funksionon si Agjenci e Pavarur në mbështetje të plotë të këtij legjislacioni.

Dy çështje thelbësore kanë mbetur pa u zgjidhur, që të dyja jashtë mundësive që AKP-ja t'i zgjidh vetë. Këto dy çështje janë: emërimi i dy anëtarëve vendorë në Bordin Mbikëqyrës të AKP-së, dhe emërimi i Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së. Këto pozita plotësohen me propozimin e Kryeministrit dhe më pas emërimin e tyre nga Kuvendi i Kosovës. Nominimet për këto tri pozitat janë bërë nga ana e Kryeministrit qysh në vitin 2009, por Kuvendi ka refuzuar të nominuarit në seancën e tij të 25 qershorit 2009. Tani çështja mbetet tek Kryeministri, i cili sërish duhet t'ia paraqes propozimet Kuvendit.

AKP-ja në pjesën më të madhe mbështetet në ndihmën e donatorëve për të siguruar fonde të mjaftueshme për të përmbushur mandatin e saj. Që nga fundi i vitit 2009, falë dhe mbështetjes së madhe të donatorëve dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës ka shtuar mbështetjen e saj buxhetore për vitin 2010 duke mbuluar 35% të buxhetit të përgjithshëm të AKP-së. Donatorët e AKP-së vazhdojnë të inkurajojnë Qeverinë e Kosovës që të shtojë më tej kontributin e saj për buxhetin e AKP-së, e cila Agjenci tashmë është Institucion i Kosovës dhe nuk është më, ashtu siç ishte përceptuar më herët, një organizatë ndërkombëtare nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut.

Çështja e Zyrave të AKP-së në Serbi, të mbyllura nga Qeveria e Serbisë në qershor 2008, ende nuk është çështje e zgjidhur. Në mars të vitit 2009, UNHCR-ja ka ofruar ndihmë në adresimin e kësaj çështjeje me ç'rast është miratuar një Memorandum i Mirëkuptimit (MiM) mes AKP-së dhe UNHCR-së në Prishtinë, e cili do të lejonte hapjen e Zyrave të UNHCR-së për Pronën në Serbi për të marrë përsipër punën e bërë më herët nga Zyret e AKP-së në Serbi. MiM-ja është nënshkruar më 19 gusht 2009, por hapja e Zyrave të UNHCR-it për Pronën në Serbi ende është në pritje.

Gjatë vitit 2009 është zgjidhur me sukses çështja që i përket mbështetjes së Policisë së Kosovës ndaj AKP-së, por, gjithashtu ka pasur edhe pengesa të cilat kanë çuar në ndërprerjen e lëshimit të vendimeve nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) dhe anulimin e atyre vendimeve të cilat tashmë veçse ishin marrë.

Në fillim të vitit 2009 janë hasur probleme që i përkasin mbështetjes së ofruar nga ana e Policisë së Kosovës (PK) në zbatimin e urdhër-dëbimeve të Skemës së Qiradhënies vullnetare të AKP-së. Fillimisht këto probleme janë hasur në regjionin e Pejës por më vonë janë evidentuar edhe në regjionin e Gjilanit. Në konsultim me zyrtarët e lartë nga Zyra Qendrore e AKP-së dhe me mbështetjen e EULEX-it është negociuar dhe dakorduar një MiM i ri mes AKP-së dhe PK-së, dhe ky MiM është nënshkruar më 19 tetor 2009. Pas zbatimit të këtij Memorandumi, i cili përfshin edhe procedurat e reja, sipas së cilave AKP-ja së pari duhet të bëjë përpjekje të dëbimit pa mbështetjen e policisë, problemet janë zgjidhur dhe PK-ja tani ofron mbështetje të plotë në kërkesën e AKP-së për të gjitha llojet e dëbimeve të ndërmarrura nga AKP-ja.

Në qershor 2009 është zbuluar se janë bërë disa gabime sa i përket notifikimit fizik të disa pronave, për të cilat është bërë kërkesë, kryesisht gjatë viteve 2006 dhe 2007, duke vazhduar edhe gjatë viteve 2008 dhe 2009. Këto gabime, kryesisht, kanë të bëjnë me notifikimin fizik të ngastrave bujqësore dhe në pjesën më të madhe iu atribuohen mungesës së të dhënave kadastrale adekuate për AKP-në në atë kohë, dhe ndarjes së kufizuar fizike të shumë ngastrave bujqësore. Gjithashtu, duhet theksuar faktin se në shumë raste vet paraqitësit e kërkesës e kishin të pamundur të njoftonin me saktësi njësitet e notifikimit për lokacionin e pronës së kërkuar. Me qëllim të adresimit të problemit, janë bërë diskutime gjithëpërfshirëse me Agjencinë

Kadastrale të Kosovës (AKK) për të siguruar qasje të lirë në të dhënat gjeografike dhe tekstuale të kadastrës sipas legjislacionit në fuqi. Me mbështetjen e plotë të donatorëve dhe aksionarëve të AKP-së, është dakorduar dhe nënshkruar një MiM mes AKP-së dhe AKK-së më 13 Korrik 2009. Zbatimi i MiM-së i ka ofruar AKP-së të dhënat e nevojshme për të kontrolluar notifikimet fillestare dhe në rastet ku janë gjetur gabimet, janë aplikuar procedurat e nevojshme për të përmirësuar gabimet fillestare. Në rastet kur vendimi mbi kërkesën tashmë ishte marrur nga KKPK-ja, në këto procedura është përfshirë kërkesa e paraqitur pranë KKPK-së për të shfuqizuar vendimin e tij fillestar. Pas këtij vendimi, paraqitësve të kërkesave dhe palëve përgjegjëse u janë ofruar informata të nevojshme mbi shfuqizimin e vendimit dhe prona është notifikuar në mënyrë të saktë.

Kjo çështje ka çuar në reduktimin e numrit të kërkesave për të cilat është vendosur gjatë kësaj periudhe, pasi që vendimet e shfuqizuara nga KKPK-ja duhet të ri-procedohen pas ri-notifikimit të pronave të kërkuara. Pritet që procesi të vazhdojë tutje dhe shpejt në shumicën e lëndëve ku nuk janë identifikuar palë të reja përgjegjëse. Në rastet kur identifikohen palë të reja përgjegjëse, kërkesat duhet të ri-procedohen si kërkesa kontestuese. Me qëllim që të mos ketë më probleme, në të gjitha kërkesat për të cilat tashmë është marrë vendim nga KKPK-ja që nga qershori 2009 është bërë kontrollimi i notifikimit fizik fillestar para paraqitjes së tyre. Kjo është bërë në 4,423 kërkesa të vendosura dhe 4,707 kërkesa të zbatuara deri në fund të vitit 2009. AKP-ja aktualisht është duke punur në metodën e trajektimit të kontrollimit të procesit të notifikimit dhe ri-notifikimit, dhe pritet që procesi i vendimmarrjes në kërkesa, përfshirë këtu edhe zbatimin e vendimeve, të kthehet në binarë në një periudhë të shkurtë dhe të arsyeshme kohore.

Andy Sparkes,
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës
Agjencia Kosovare e Pronës
Janar, 2010

KAPITULLI I

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

1.1 Themelimi dhe mandati

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) është themeluar si Agjenci e Pavarur me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 për zgjidhjen e kërkesave mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, e cila i ka ofruar Agjencisë mandat të qartë dhe ndarje të roleve në mes tri organeve të saj kryesore, më saktë: Sekretarisë Ekzekutive, Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) dhe Bordit Mbikëqyrës. Pasi që efekti ligjor i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ka përfunduar më 31 dhjetor 2008, tani Agjencia operon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-079 të Kuvendit të Kosovës, me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. (Legjislacionit e Aplikueshëm). Me këtë rast duhet theksuar se natyra dhe funksionimi i pavarur i Agjencisë nuk është ndryshuar me këtë Ligj.

Mandati i AKP-së është të zgjidhë kërkesat pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit, me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës, për pronën e paluajtshme private, përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, që janë rezultat i konfliktit të armatosur, i cili ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Me këtë rast, AKP-ja ka pranuar mbi 40,500 kërkesa, prej të cilave parafërsisht 90% janë pranuar përmes zyrave të AKP-së në Serbi.

AKP-ja ka gjithashtu mandat të merret me një numër të caktuar të aktiviteteve që ishin në mandatin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) i cili ishte themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/23, mbyllja e së cilit përkon me krijimin e AKP-së. Përgjegjësitë përfshijnë zbatimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB), të cilat ishin në pritje të zbatimit dhe menaxhimit të pronave nën administrimin e DÇPB-së. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të vet, AKP-ja ka marrë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së. Gjithashtu, asetet fizike të DÇPB-së i janë transferuar AKP-së dhe një numër i caktuar i personelit të saj janë ricaktuar në detyra të ngjashme brenda AKP-së.

1.2 Struktura Organizative

AKP-ja funksionon si organ i pavarur sipas Nenet 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndonëse Qeveria dhe Donatorët kanë rol të rëndësishëm në AKP përmes Bordit Mbikëqyrës. AKP-ja përbëhet nga tri organe kryesore, më saktë nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKPK) - quasi-judicial autonom, dhe Bordi Mbikëqyrës, i cili ofron mbikëqyrje administrative, udhëheqje të përgjithshme dhe udhëzime për linjën e veprimit. Përveç kësaj, përmes zyrave regjionale të saj, AKP-ja është e pranishme në pesë regjionet e Kosovës, gjithashtu edhe në Mal të Zi dhe Maqedoni. Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet e të gjitha këtyre zyrave kordinohen nga Kordinatori Regjional i cili gjendet në ZK të AKP-së. Ndonëse këto zyra janë përdorur kryesisht si lokacione, në të cilat është bërë pranimi i kërkesave, tani qëllimi është që zyrat të funksionojnë si pika kryesore ku shumica e paraqitësve të kërkesave mund të dorëzojnë dokumentacion shtesë dhe të marrin vendimet mbi kërkesat e tyre. Sa i përket zyrave të AKP-së në Serbi, në mars 2009, ishte bërë një propozim nga UNHCR-i që të lehtësojë veprimtarinë e AKP-së në Serbi. Teksti i Memorandumit të Mirëkuptimit (MiM) ishte dakorduar mes UNHCR-it dhe AKP-së, e i cili Memorandum do të lejonte hapjen e Zyrave të UNHCR-it për Pronën në Serbi. Sipas këtij MiM veprimtaria e ndërmarrur më herët nga AKP-ja do të përmbushej prapë në Serbi, përfshirë këtu qasjen në arkivat e zhvendosura pronësore, pastaj edhe kontaktin e drejtpërdrejtë me paraqitësit e kërkesave për dorëzimin e vendimeve të KKPK-së, si dhe për mbledhjen e dokumentacionit shtesë nga paraqitësit e kërkesave. Ky memorandum është nënshkruar mes AKP-së dhe UNHCR-it më 19 gusht 2009, ku edhe është rënë dakord për zbatimin e dispozitave të tij. Hapja e Zyrave të UNHCR-it për Pronën është në pritje të pajtimit nga Qeveria e Serbisë.

1.2.1 Sekretaria Ekzekutive

Përgjegjësitë kryesore të Sekretarisë Ekzekutive përfshijnë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave, përgjigjet ndaj kërkesave dhe përpunimin e këtyre kërkesave para se ato t'i paraqiten KKPK-së për shqyrtim. Kjo përfshinë veprimtaritë si në vijim:

- (i) njoftimi i shfrytëzuesve të pronave, për të cilat është bërë kërkesë, dhe publikimi i kërkesave për palët e interesuara;
- (ii) publikimi i kërkesave të paraqitura në Agjenci;
- (iii) verifikimi i dokumenteve;
- (iv) mbledhja e dëshmimeve dhe mbajtja e intervistave me palët e përfshira në kërkesë;
- (v) përgatitja e parashtrësve në lidhje me kërkesat; si dhe
- (vi) referimi i kërkesave pranë Komisionit për vendimmarrje.

Gjithashtu, AKP-ja ka mandatin të sigurojë zbatimin efektiv të vendimeve përfundimtare të KKPK-së dhe të aktgjykimeve mbi ankesat e Gjykatës Supreme. Kjo është arritur përmes mjeteve ligjore, të cilat përfshijnë por nuk janë të kufizuara në: vënia e pronës nën administrim të AKP-së, riposedimi, konfiskimi i ndërtimeve të paligjshme, ankandi, kompensimi dhe marrëveshjet e qirasë, ku të gjitha do të lehtësojnë dhe sigurojnë kthimin e pronave tek bartësitë e ligjshëm të së drejtës pronësore.

Sipas legjislacionit në fuqi, Kryeministri duhet të propozojë Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive ku më pas ata emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Deri në përfundim të mbikëqyrjes së zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive do të emërohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN). PCN-ja e ka bërë emërimin e nevojshëm në qershor 2008. Megjithatë, në lidhje me emërimin e zv. Drejtorit Ekzekutiv, Kryeministri ia ka dorëzuar propozimet e tij Kuvendit të Kosovës, megjithatë Kuvendi në seancën e tij të 25 qershorit 2009 ka refuzuar propozimet dhe tani çështja mbetet tek Kryeministri, i cili sërish duhet t'i paraqes kandidatët e propozuar. Për të parandaluar boshllëkun, zv. Drejtori Ekzekutiv aktual mbetet edhe më tutje në pozitë.

- Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive është z. Scott Bowen;
- Zv. Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive është z. Xhevat Azemi.

1.2.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës

Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) i është dhënë jurisdiksioni që të vendos mbi kërkesat, të cilat referohen nga Sekretaria Ekzekutive. Sipas legjislacionit në fuqi, Presidenti i Gjykatës Su-

preme duhet t'i propozojë tre anëtarë për KKPK, ku mandej ata emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Deri në përfundim të mbikëqyrjes së zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dy nga tre anëtarët, përfshirë edhe Kryetarin e Komisionit, do të emërohen nga PCN-ja. PCN-ja ka bërë emërimet e nevojshme më 6 mars 2009, dhe Kuvendi i Kosovës ka emëruar anëtarin vendor më 12 mars 2009.

Sekretaria Ekzekutive i ofron KKPK-së mbështetje administrative, teknike dhe ligjore, të cilin e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij ligjore përmes personelit, i cili e mbështet në mënyrë juridike dhe administrative.

Anëtarët e Komisionit janë:

- **Z. Veijo Heiskanen** (Finlandë) është kryetar i Komisionit. Më parë ai ka qënë anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës. Ka diplomuar në Universitetin e Helsinkit dhe në Shkollën Juridike të Harvardit. Para pozitës së tij në LALIVE në Gjenevë, ai mes tjerash ka shërbyer edhe si Sekretar i Përgjithshëm dhe Gjyqtar i Lartë i Kërkesave në Tribunalin për Zgjidhjen e Kërkesave për Xhirollogaritë e Papërdorura në Zvicër. Zëvendës Kryetar i Shërbimit Ligjor të Komisionit për Kompensim të KB dhe Këshilltar Ligjor në Tribunalin e Kërkesave Iran-SHBA. Ka ligjëruar dhe ka mbajtur pozita akademike në institucione të ndryshme, përfshirë edhe në Universitetin e Helsinkit dhe Akademinë e Ligjit Ndërkombëtar në Hagë, dhe Universitetin e Lozanës. Është autor i publikimeve të shumta mbi Ligjin Ndërkombëtar; Arbitrimin Ndërkombëtar dhe zgjidhje të kontesteve.
- **Z. Norbert Wühler** (Gjermani) është anëtar ndërkombëtar i Komisionit. Ka diplomuar dhe mbrojtur doktoraturën në lëmin e drejtësisë në Universitetin e Heidelbergut. Aktualisht është Drejtor i Programeve për Rindërtim në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim. Pozitat e mëparshme të tij përfshijnë: Udhëheqës i Filialit të Shërbimeve Ligjore të Komisionit për Kompensim të Kombeve të Bashkuara (1992-2000), Këshilltar Ligjor i Kryetarit dhe Zëvendës i Sekretarit të Përgjithshëm të Tribunalit për Kërkesa Iran-SHBA (1983-1991), Partner Hetimi në Institutin Max Planck për Ligjin Krahësues Publik dhe Ligjin Ndërkombëtar në Heidelberg (1978-1983), dhe Përfaqësues Ligjor i pranuar tek Avokatët e Heidelbergut dhe Manheim-it (1979-1983). Ishte kryetar, anëtar dhe sekretar i disa gjykatave ndërkombëtare arbitrare, këshilltar i Komisionit të Kërkesave për Pronën e Pajuatshme në Bos-

një dhe Hercegovinë dhe Komisionit për Kërkesa Eritre-Etiopi, dhe është anëtar i Komisionit Drejtues mbi Proceset Ndërkombëtare të Kërkesave në numër të madh në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Ka ligjëruar dhe publikuar punime mbi kërkesat ndërkombëtare pronësore dhe për kompensim, zgjidhjen e kontesteve, përgjegjësi në shtetërore dhe arbitrimin ndërkombëtar.

- **Z. Adem Vokshi** (Kosovë) është anëtar vendor i KKP-së. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në vitin 1975. Prej vitit 1975 deri më 1978 ka bërë praktikën në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe prej vitit 1978 deri më 1982 ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Prej vitit 1982 deri më 2009 ka punuar si avokat në Mitrovicë, dhe ka specializuar në fushën e të Drejtave Civile dhe Administrative. Prej vitit 2004-2006 ka qenë Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës. Ka ligjëruar dhe ka udhëhequr seminare mbi çështjet të ndryshme ligjore për institucionet vendore dhe ndërkombëtare përfshirë Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Këshillin e Evropës, Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës. Temat e përfshira janë: mbrojtja në procedurat gjyqësore, dëshmitë, përfaqësimi i palëve në procedurat civile, ofrimi i ndihmës juridike për komunitetet e minoriteteve në Kosovë, zbatimi i procedurave kontestuese, jokontestuese dhe ekzekutive, mbrojtja e viktimave, transparenca dhe anti-korrupsioni në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe parandalimi i krimit financiar. Ai gjithashtu ka udhëhequr seminare të ndryshme mbi ofrimin e ndihmës juridike falas. Prej vitit 2002 ai ligjëron procedurën civile për kandidatët që trajnohen për provimin e judikaturës dhe prej vitit 2008 ligjëron procedurën civile për kandidatët që trajnohen për gjyqtarë. Z. Vokshi gjithashtu ka marrë pjesë në të gjitha juridiksionet në Kosovë, edhe në nivel të Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme. Ai gjithashtu ka qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

1.2.3 Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës ka mandat për të mbikëqyrur punën e AKP-së dhe për t'i siguruar asaj mbikëqyrje administrative, udhëheqje të përgjithshme dhe udhëzim për linjën e veprimit. Megjithatë, Bordit në mënyrë të qartë i është ndaluar pjesëmarrja në procesin gjatë të cilit KKP-ja shqyrton dhe i merr vendimet mbi kërkesat. Sipas legjislacionit në fuqi, Kryeministri duhet t'i propozojë pesë anëtarë të Bordit Mbikëqyrës, të cilët më pas duhet të emërohen nga

Kuvendi i Kosovës. Deri në përfundim të mbikëqyrjes së zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, tre anëtarë, përfshirë këtu edhe Kryetarin, do të emërohen nga PCN-ja. PCN-ja ka bërë emërimet e nevojshme në qershor dhe korrik të vitit 2008, megjithatë një anëtar i Bordit ka dhënë dorëheqje pasi është laguar nga Kosova dhe pritet emërimi i Anëtarit të ri të Bordit për zëvendësimin e tij. Sa i përket anëtarëve vendorë të Bordit Mbikëqyrës, Kryeministri ia ka bërë propozimet Kuvendit të Kosovës, megjithatë Kuvendi në seancën e tij të 25 qershorit 2009 ka refuzuar propozimet dhe çështja tani mbetet tek Kryeministri, i cili sërish duhet t'i paraqes kandidatët e tij të propozuar.

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë:

- Z. Andy Sparkes, Ambasadori i Britanisë në Kosovë, gjithashtu është emëruar edhe Kryetar i Bordit;
- Z. Peter Sorensen.

Si rezultat përfundimtar të kësaj kemi mos-formimin e Bordit Mbikëqyrës gjatë periudhës së raportimit. Ky boshllëk ishte plotësuar me të ashtuquajturin Komiteti i Aksionarëve, kolegji i përfaqësuesve të organizatave të ndryshme në Kosovë, të cilat kanë shprehur interesim për të ndihmuar AKP-në në përmbushjen e mandatit të saj. Këtu përfshihen donatorët e AKP-së; EULEX-i, PCN-ja, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Anëtarët aktualë të Bordit Mbikëqyrës, të cilët në mungesë të funksionimit të Bordit Mbikëqyrës i kanë ofruar AKP-së udhëzimet për linjën e veprimit. Komiteti i Aksionarëve është takuar në baza të rregullta në forumin e kryesuar nga Kryetari i Bordit Mbikëqyrës. Komiteti i Aksionarëve do të vazhdojë të takohet deri atëherë kur Bordi Mbikëqyrës të jetë në përbërje të plotë me të gjithë anëtarët e tij.

Drejtori Ekzekutiv i Sekretarisë Ekzekutive e ka prezantuar Sekretarinë Ekzekutive para Bordit Mbikëqyrës dhe Sekretaria Ekzekutive i ofron shërbime të sekretarisë Bordit Mbikëqyrës. Kjo ndihmë përfshin: organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës për takime dhe procesverbalin e takimeve, shpërndarjen e dokumenteve relevante si dhe informatat dhe monitorimin e veprimeve pasuese në lidhje me udhëzimet e pranuar.

KAPITULLI II

PRANIMI I KËRKESAVE DHE NJOFTIMI I PALËVE

2.1 Statistikat mbi Numrin e Kërkesave të Regjistruara

Deri në datën e mbylljes së afatit për pranimin e kërkesave më 3 dhjetor 2007, janë të regjistruara rreth 38,335 kërkesa. Gjatë përpunimit të kërkesave ishte zbuluar që një numër i kërkesave, të cilat ishin paraqitur si kërkesa individuale për ngastra të shumëfishta, dhe të cilat në kohën e paraqitjes ishin përshkruar si afër njëra-tjetrës, apo të ngjitura, në fakt ishin tërësisht të ndara. Ky fakt është zbuluar vetëm pas notifikimit të vet kërkesave, për të cilat kërkohej identifikimi dhe inspektimi i ngastrës(ave) në fjalë. Si rezultat, dhe deri në përfundimin e periudhës së raportimit, numri i kërkesave të regjistruara është rritur në 40,318. Megjithatë, rritja e numrit nuk

përfshinë kërkesa të reja të paraqitura pas mbylljes së afatit, por vetëm ndarjen dhe ri-regjistrimin e kërkesave tashmë të paraqitura

Rreth 36,139 kërkesa (89.6% nga numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar) kanë të bëjnë me tokat bujqësore, ndërsa 1,000 kërkesa (2.5%) janë paraqitur për pronat komerciale dhe 3,179 (7.9%) kanë të bëjnë me pronat banesore. Në 99% të kërkesave, paraqitësit e kërkesave kërkojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar. Numri më i madh i kërkesave të paraqitura ka të bëjë me pronat, të cilat gjenden në regjionin e Pejës (34.3%). Tabelat e mëposhtme paraqesin natyrën, ndarjen gjeografike dhe numrin e kërkesave të paraqitura.

NATYRA E SË DREJTËS PRONËSORE TË KËRKUAR

Regjioni/Kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e Kërkesave
Pronësia	8821	4194	13736	6827	6354	39932	99
Të Drejtat për Shfrytëzim	30	57	85	151	63	386	1
Kompensimi	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	8851	4251	13821	6978	6417	40318	100
% e kërkesave	22.0	10.5	34.3	17.3	15.9	100	100

KLASIFIKIMI I PRONAVE

Regjioni/ Lloji i pronës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e Kërkesave
Banesore	555	304	1089	748	483	3179	99
Komerciale me ndërtesa	116	146	280	351	107	1000	1
Komerciale pa ndërtesa	8180	3801	12452	5879	5827	36139	0
Gjithsej	8851	4251	13821	6978	6417	40318	100
% e kërkesave	21.8	10.5	34.3	17.3	15.9	100	100

KËRKESAT SIPAS KOMUNAVE

Komuna	Të paraqitura:	%
Deçan	669	1.66
Dragash	7	0.02
F. Kosovë	375	0.93
Ferizaj	3003	7.45
Gjakovë	730	1.81
Gjilan	1509	3.74
Gllogoc	58	0.14
Istog	5595	13.88
Kaçanik	247	0.61
Kamenicë	1488	3.69
Klinë	3512	8.71
Leposaviq	76	0.19
Lipjan	1501	3.72
Malishevë	461	1.14
Mitrovicë	553	1.37
Novo-Bërde	797	1.98
Obiliq	430	1.07
Pejë	3315	8.22
Podujevë	2071	5.14
Prishtinë	2319	5.75
Prizren	3530	8.76
Rahovec	599	1.49
Shtërpcë	118	0.29
Shtime	224	0.56
Skenderaj	1634	4.05
Suharekë	1820	4.51
Viti	1689	4.19
Vushtrri	1574	3.90
Zubin Potok	321	0.80
Zveçan	93	0.23
Gjithsej të paraqitura	40318	100.00

2.2 Njoftimi mbi Kërkesat

Njoftimi mbi kërkesat mbikëqyret nga Njësiti i Informimit dhe bëhet nga personeli i Zyrave Regjionale. Dispozitat e legjislationit të aplikueshëm shqyrtojnë dhe rregullojnë pjesëmarrjen e palëve dhe sigurojnë që procedurat përkatëse të procedimit të kërkesave dhe vendimmarrja mbi kërkesat të përmbushin standardet e kërkuara të procedimit dhe procedurave të paanshme. Legjislationi në fuqi i paraqet hapat proceduralë, të cilët kërkojnë të ndërmerren për të siguruar që palët, të cilat kanë interes ligjor në pronën e kërkuar, të njoftohen mbi kërkesën dhe t'u ofrohet mundësia për të marr pjesë në procedura. Kjo qasje është kryesorja gjatë procesit, meqë duke ditur që mbi kërkesat vendoset bazuar në parashtresat me shkrim dhe zakonisht palët nuk kanë mundësi të prezantojnë dëshmi apo argumente gojore para KKPK-së.

Sekretarisë Ekzekutive i është kërkuar t'i njoftojë dhe t'u dërgojë kopjen e kërkesës çdo personi të ndryshëm nga paraqitësi i kërkesës, i cili ushtron apo pretendon të ketë të drejtë mbi pronën, e cila është lëndë e kërkesës, dhe po ashtu të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person, i cili mund të ketë interes ligjor mbi pronën. Palët e njoftuara kanë të drejtë të përgjigjen në kërkesë dhe të paraqesin shkresat, apo të prezantojnë dëshmitë në lidhje me kërkesën.

Palët njoftohen përmes dorëzimit të formularit të njohur si 'formulari për njoftimin mbi kërkesën', i cili jep detajet mbi kërkesën dhe natyrën e të drejtës së kërkuar pronësore mbi pronën. Formulari për njoftimin mbi kërkesën shoqërohet me formularin e njoftimit mbi pjesëmarrjen, i cili njofton palët mbi të drejtën e tij/saj për të marrë pjesë në procedurë duke plotësuar njoftimin dhe paraqitur atë në AKP brenda tridhjetë (30) ditësh, apo përndryshe duke u paraqitur personalisht në zyrën e AKP-së për t'i dhënë informatat e tilla.

Kur personi, i cili ka interes ligjor në kërkesë, nuk ka pranuar njoftimin mbi kërkesën, rregullat e procedurës parashohin që ai/ajo mund të pranohet si palë në çdo shkallë të procedurës, nëse nuk është vendosur përfundimisht mbi kërkesën nga KKPK-ja.

Gjatë implementimit të vendimeve të marra nga KKPK-ja nga Sekretaria Ekzekutive është konstatuar se janë bërë një numër gabimesh sa i përket saktësisë gjatë procesit të notifikimit fizik fillestar. Me atë rast janë bërë vlerësimet ku kjo shkallë gabimi mund

të shkojë në mbi 30% të rasteve, të cilat ishin notifikuar fizikisht gjatë viteve 2006 dhe 2007. Arsyeja kryesore e kësaj lëshimeve ishte mungesa e të dhënave kadastrale dhe presioni i bërë për të bërë notifikimin ashtu që të mund të fillojë procesi i vendimmarrjes mbi kërkesat. Gjithashtu, duhet theksuar që në raste të caktuara ka ndodhur që edhe paraqitësit e kërkesave kishin dhënë informata të gabuara mbi lokacionin e pronës së tyre.

KKPK-ja në seancën e saj në qershor 2009 ka anuluar dorëzimin e vendimeve deri në kohën kur Sekretaria Ekzekutive të mund të konfirmojë saktësinë e notifikimit në ato kërkesa, për të cilat tashmë ishte marrë vendimi dhe kishte vendosur që të mos i paraqiten kërkesa tjera për vendimmarrje pa u bërë konfirmimi i duhur. Sekretaria Ekzekutive me mbështetjen e Asionarëve të AKP-së ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MiM) me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe më pas ka ndryshuar procedurat e saj ku ka zbatuar procedura të reja për të bërë konfirmimin e kërkuar nga KKPK-ja, dhe t'i adresojë ato raste në të cilat është konstatuar që konfirmimi është negativ.

2.3 Publikimi i Kërkesave

Publikimi i kërkesave mbikëqyret nga Njësiti i Informimit. Procedura e publikimit përfshinë publikimin zyrtar të regjistrit me të gjitha kërkesat e paraqitura në AKP, në buletin e njohur si Gazeta e AKP-së, e cila përmban adresën e pronës për të cilën është paraqitur kërkesa së bashku me numrin e kërkesës. Gazeta shpërndahet si shtojcë e një gazete në gjuhën shqipe dhe e një gazete në gjuhën serbe (përkatësisht me 15,000 kopje dhe 20,000 kopje). Gazeta siguron që detajet e të gjitha pronave të kërkuara të arrijnë tek palët e interesuara dhe palët e mundshme përgjegjëse brenda dhe jashtë Kosovës. 5,000 kopje tjera në mënyrë të rregullt shpërndahen në të gjitha komunat, gjykatat, enklavat, organizatat për PZh-të dhe OJQ-ve në tërë Kosovën. Gjithashtu, gazeta publikohet edhe në ueb faqen e AKP-së.

Gjatë periudhës së raportimit, nuk është publikuar asnjë numër i Gazetës kryesisht për shkak të mbylljes së Zyrevë të AKP-së në Serbi, dhe prandaj, numri i përgjithshëm i kërkesave të publikuara është 38,137 (93.7% e numrit të përgjithshëm të kërkesave të pranura).

KAPITULLI III

PËRPUNIMI I KËRKESAVE

3.1 Shqyrtimi i Kërkesave

Përpunimi i kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive përfshinë: hetimin e plotë të kërkesave, verifikimin e dëshmimeve dokumentuese të paraqitura si mbështetje dhe hartimin e parashtresave ligjore, të cilat përbajnë vlerësim ligjor dhe rekomandimin mbi secilën kërkesë. Procesi i verifikimit bëhet nga personeli i zyrës regjionale nën mbikëqyrjen e Njësitit për Verifikimin e Dokumenteve.

Shqyrtimi dhe përpunimi i kërkesave është i natyrës hetuese duke ditur që dëshmitë gojore zakonisht nuk mund të jepen para KPPK-së dhe procesi i vendim-marrjes është i pakundërshtueshëm. Zyrtarët e Sekretarisë të përfshirë në përpunimin e kërkesave nuk janë të kufizuar në informacionet apo dokumentet e paraqitura nga paraqitësit e kërkesave. Ata mund të kontaktojnë palët në kërkesë kur nevojiten informata shtesë dhe mund të ndërmarrin çdo hetim tjetër, ex officio kur është e nevojshme, për të vërtetuar të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me kërkesën.

3.2 Qasja në të Dhënat Pronësore dhe Verifikimi i Dokumenteve

Hulumtimi i plotë i të gjitha burimeve efikase të dëshmimeve dokumentuese mbi të drejtat pronësore është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e saktë të së drejtës pronësore. Kështu që, njëri ndër hapat e parë thelbësor të përfshirë në përpunimin e kërkesave përfshinë zyrtarët e Sekretarisë Ekzekutive në tentativë të verifikojnë dokumentet e paraqitura në mbështetje të kërkesave, apo të bëjnë hulumtime ex officio në të dhënat pronësore publike në rastet kur paraqitësit e kërkesave nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentuese.

Deri më tani sa i përket qasjes në dokumentet brenda territorit të Kosovës, dispozitat e ligjit në fuqi parashohin që Sekretaria Ekzekutive të ketë qasje të lirë dhe të hapur në të gjitha të dhënat. Në mënyrë të njëjtë, po ashtu, edhe KPPK-ja ka qasje të lirë në të gjitha të dhënat në Kosovë, të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e kërkesës, apo për çdo proces tjetër të verifikimit. Në lidhje me këtë më 13 korrik 2009 AKP-ja dhe AKK-ja kanë nënshkruar MiM-në ashtu që AKP-së i është aprovuar qasje e lirë në të dhënat e AKK-së.

Qasja në të dhënat e pronës në Serbi është gjithashtu shumë e rëndësishme për verifikimin e kërkesave, duke ditur që një pjesë e konsiderueshme e të dhënave pronësore nga Kosova gjenden atje. Pas mbylljes së zyrave të AKP-së në Serbi, qasja e papenguar, të cilën AKP-ja e gëzonte më herët në arkivat e pronës të zhvendosura atje, gjithashtu është anuluar. Aktualisht 226 kërkesa janë në pritje të verifikimit në arkivat e pronës të zhvendosura në Serbi, i cili numër është zvogëluar nga numri fillestar gjithsej 3,500 kërkesa, pasi që AKP-ja ka gjetur metoda alternative për të verifikuar dokumentacionin e paraqitur.

3.3 Përpilimi i Parashtresave Ligjore mbi Kërkesat

Pasi që kërkesa të jetë regjistruar dhe dokumentacioni mbështetës të jetë verifikuar për vërtetësinë e tij, kërkesa shqyrtohet nga zyrtarët ligjorë në Njësitin për Përpunimin e Kërkesave ("NJPK") të cilët përgatisin parashtresat ligjore që përbajnë vlerësimin e kërkesës dhe rekomandimet nëse kërkesa duhet të aprovohet apo refuzohet. Të gjitha detajet thelbësore, sa i përket kërkesës, shtjellohen në parashtresat ligjore të cilat më pastaj i prezantohen KPPK-së së bashku me dosjen e kërkesës. Kjo bëhet sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi, i cili parashihet rolin e Sekretarisë Ekzekutive në përgatitjen e "parashtresave dhe dëshmimeve, përkthimit të dëshmimeve dhe rekomandimeve në lidhje me të gjitha kërkesat" për KPPK-në.

Parashtresat ligjore përgatiten në formatin standard në dokumentin e njohur si 'raporti i përpunimit të kërkesës.' Shabllonet elektronike të raportit mbi përpunimin e kërkesave janë përgatitur nga Sekretaria Ekzekutive para seancës së parë të KPPK-së, në konsultim me Kryetarin e KPPK-së. Gjatë seancave të KPPK-së raportet janë korrigjuar dhe standardizuar për t'u siguruar që me saktësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse ato paraqesin informatat thelbësore të cilat i nevojiten KPPK-së për të vendosur mbi kërkesat. Në esencë raporti përmban faktet thelbësore dhe bazat ligjore mbi kërkesën, të drejtën e pohuar pronësore dhe çdo dëshmi dokumentuese në mbështetje të kërkesës. Raporti është i dizajnuar të përmbajë detajet mbi çështjet kryesore ligjore dhe faktike të ngritura nga palët në kërkesë dhe paraqet

detajet në lidhje me njoftimin e palëve të prekura nga kërkesa, dokumentet ligjore të paraqitura nga palët, natyrën e verifikimit të bërë dhe nëse është paraqitur më shumë se një kërkesë për pronën e kërkuar. Kur ndërtesat apo objektet në pronë janë të shkatërruara, kërkohet që raporti të paraqes këtë fakt dhe të përmbajë një përshkrim të shkurtër të gjendjes aktuale të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës zotëron objektin(et) e shkatërruar(a) dhe tokën në të cilën gjendej ajo, dhe nëse aktualisht është e uzurpuar apo është duke u shfrytëzuar për ndonjë qëllim.

KPPK-ja në asnjë mënyrë nuk është i kufizuar në rekomandimin nga raporti i përpunimit të kërkesës. Përmes një apo më shumë anëtarëve të vet, ai bënë shqyrtim të pavarur të dëshmimeve dokumentuese.

Merr vendimin përfundimtar për secilën kërkesë, pas shqyrtimit të rekomandimeve nga raporti dhe bazuar në vlerësimin e vet të pavarur mbi çështjet.

KPPK-ja ndihmohet në punën e saj nga Zyra e KPPK-së e cila përbëhet nga personeli juridik, administrativ dhe gjuhësor, dhe i cili i ofron përkrahje juridike dhe logjistike KPPK-së para, gjatë dhe pas seancave të saj. Zyra e KPPK-së mbanë kontakte të rregullta me Komisionerët, bënë kontrollin e kualitetit të kërkesave të paraqitura Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive, bënë hulumtime ligjore, i përgatit draft-vendimet dhe vendimet e individualizuara për paraqitësit e kërkesave dhe palët përgjegjëse nën mbikëqyrjen e Kryetarit të KPPK-së.

KAPITULLI IV

VENDIMMARJA MBI KËRKESAT NGA KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE I KOSOVËS

4.1 Natyra e Kërkesave të Vendosura

Komisioni ka mbajtur katër seanca gjatë periudhës së raportimit, duke vendosur mbi 4,423 kërkesa. Prej tyre, 12 kërkesa janë kontestuar nga uzurpuesi/pala përgjegjëse të cilët janë paraqitur në zyrën e AKP-së pasi që prona ishte notifikuar dhe publikuar. Ky numër është dukshëm më i vogël se synimi i cekur në Planin e Punës së AKP-së, kryesisht për shkak të çështjes së notifikimit të përshkruar më sipër, dhe për shkak të faktit që më herët janë shqyrtuar kërkesat më të lehta dhe tash janë duke u shqyrtuar kërkesat më të vështira.

Në shumicën e rasteve KPPK-ja, në konfirmimin e të drejtave pronësore, mbështetet në dokumentet, të cilat janë vërtetuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive në Agjencinë Kosovare të Kadastrës ('AKK') dhe rrjedhimisht në raste të tilla vendimi i Komisionit është në përputhje me shënimet për pronarin në të dhënat e AKK-së. Në një numër të rasteve Komisioni në vendimet e tij ka konfirmuar të drejtat pronësore të cilat nuk ishin të regjistruara në të dhënat e AKK-së për shkak të faktit se të dhënat nuk janë azhuruar. Kjo ka ndodhur në rastet ku ka pasur bartje të pronës apo vendim të gjykatës të cilat ndikojnë në të drejtën, dhe nuk ishin të regjistruara në AKK. Në raste të tilla vendimi i KPPK-së konfirmon të drejtën mbi

pronën dhe më pas bartësi i së drejtës pronësore mund të paraqitet në AKK me qëllim të azhurimit të të dhënave të cilat do të reflektojnë vendimin.

Puna e KPPK-së në konfirmimin e të drejtave pronësore, në raste të tilla, është e një rëndësie vendimtare. Vetëm shënimet në të dhënat e AKK-së nuk do të ishin të mjaftueshme për t'i kthyer posedimin e pronës paraqitësve të kërkesave kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme. Kur KPPK-ja konfirmon të drejtat pronësore, ai mund të urdhërojë në favor të paraqitësit të kërkesës riposedimin e pronës dhe ndonjë urdhër tjetër të rëndësishëm, i cili shihet si i nevojshëm për t'i mundësuar bartësit të së drejtës pronësore të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore. Kështu që, KPPK-së në mënyrë të qartë i janë dhënë kompetencat për të siguruar vendime në pajtueshmëri me detyrimet ligjore në favor të bartësve të së drejtës pronësore. AKK-ja nuk ka jurisdiksion të tillë dhe bartësit e të drejtës pronësore, duke u mbështetur në shënimet e AKK-së, do të duhej t'i u drejtoheshin gjykatave vendore, të cilat për shkak punës së grumbulluar ekzistuese dhe burimeve të kufizuara nuk kanë mundësi t'i shqyrtojnë këto kërkesa me shpejtësi.

Kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh faktin që edhe nëse kërkesa është e pakontestuar, kjo nuk do të thotë, domosdoshmërisht, që prona nuk shfrytëzohet apo nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme; mund të jetë edhe kjo, por edhe që shfrytëzuesi nuk dëshiron të marr pjesë, për çfarëdo arsye, në procedurë. Gjithashtu, në rastet kur prona e kërkuar nuk duket si e uzurpuar në kohën e notifikimit, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që prona më herët nuk ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, apo nuk do të uzurpohet në mënyrë të paligjshme në të ardhmen. Kështu që, në rastet kur prona është e pakontestuar në ditën e lëshimit të vendimit, urdhri i Komisionit, i cili konfirmon të drejtën dhe urdhëron riposelimin, mbron të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës në skenarë të tillë të mundshëm.

Si rezultat i mosbesimit ndëretnik, i cili mbizotëron në Kosovë, shumë minoritarëve iu mungon besimi në institucionet publike. Në këto rrethana, vendimi i KPPK-së, edhe kur prona nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, konsiderohet nga bartësit e të drejtës pronësore si siguri për interesat e tyre në pronë, që të ballafaqohen me ndonjë pasiguri të cilën do ta zbulonin dhe e cila do t'i dëmtonte sa i përket ndërhyrjeve në të dhënat publike pronësore. Gjithashtu, duke ditur që shumë paraqitës të kërkesave nuk mund të kenë qasje në pronat e tyre, vendimi, i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës, ka funksion të rëndësishëm pasi që sqaron dhe konfirmon situatën aktuale ligjore, në veçanti në rrethanat ku paraqitësit e kërkesës mund të kenë humbur dokumentet e tyre të pronës, apo kur ato u janë shkatërruar në rrethanat e krijuara nga konflikti.

4.2 Statistikat për Kërkesat e Vendosura

4,423 kërkesat e vendosura nga Komisioni hynë në kategoritë në vijim:

Kategoritë e kërkesave	Numri i Kërkesave të Vendosura
Tokë bujqësore	4,140
Pronë komerciale	6
Pronë banesore	277
Gjithsej	4,423

4.3 Procedurat e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

Selia e KPPK-së është në Prishtinë dhe i është lejuar të ushtrojë funksionet e veta vendimmarrëse përmes seancave të mbajtura në Prishtinë apo gjetiu, apo t'i mbajë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike kur është e nevojshme. Seancat mbahen në baza dy-mujore ku synim kanë së paku 2,500 kërkesa të prezentuara KPPK-së në secilën seancë të vendimmarrjes. Gjuhët zyrtare të KPPK-së janë gjuha shqipe, angleze dhe serbe, por gjuha që përdoret në punën e Komisionit është gjuha angleze me përkthimet e ofruara sipas nevojës.

Kryetari i KPPK-së, në konsultim me anëtarët tjerë të Komisionit, përcakton rregullin, në të cilin kërkesat duhet t'i referohen për vendimmarrje bazuar dhe duke marr parasysh edhe informatat në lidhje me volumin e punës të ofruar nga Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive. Kërkesat, në të cilat ngriten çështje të njëjta ligjore dhe evidentuese, futen në pako së bashku në kategoritë për vendimmarrje dhe deri më tani, në përputhje me udhëzimet e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka referuar kërkesat në pakot me çështje lëndore si në vijim:

Prona Bujqësore

- Kërkesat në të cilat paraqitësi i kërkesës ishte Bartës i së Drejtës Pronësore ('BDP') në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- Kërkesat e paraqitura nga Anëtarët e Bashkësisë Familjare ('ABF') ku BDP-ja ende është gjallë apo ku vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;
- Kërkesat e paraqitura nga bartësi i Autorizimit dhe BDP-ja ende është gjallë;
- Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në datën e humbjes por është BDP aktual;
- Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë (vdekja e të cilit mund të dëshmohej) por nuk është pronar aktual i pronës; dhe kërkesa ndodh të aprovohet në emër të të ndjerit;
- Kërkesat që duhet të refuzohen;
- Kërkesat e kontestuar;

Prona Banesore

- Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës ishte BDP në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- Kërkesat e paraqitura nga ABF-ja/bartësi i Autorizimit dhe BDP-ja ende është gjallë apo ku vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;

- Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në datën e humbjes por është pronar aktual;
- Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë por nuk është pronar aktual i pronës; dhe kërkesa qëndron të aprovohet në emër të të ndjerit;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës ishte BDP në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- Kërkesat që duhet të refuzohen;
- Kërkesat e kontestuara;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe kërkesa është paraqitur nga ABF-ja/bartësi i Autorizimit dhe BDP-ja ende është gjallë apo vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në ditën e humbjes por është pronar aktual;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë por nuk është pronari aktual i pronës, dhe kërkesa qëndron të aprovohet në emër të të ndjerit;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe kërkesa qëndron të refuzohet;

Prona Komerciale

- Kërkesat e kontestuara;
- Kërkesat ku prona në fjalë nuk është e shkatërruar;
- Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar;
- Kërkesat që duhet të refuzohen.

Si rregull i përgjithshëm, KPPK-ja vendos mbi kërkesat bazuar në shkresat dhe dëshmitë dokumentuese. Prandaj, palët i paraqesin KPPK-së dëshmitë dhe argumentet e tyre përmes Sekretarisë Ekzekutive dhe kanë të drejtë të dinë për dëshmitë dhe shkresat e palëve tjera, dhe të paraqesin dëshmi dhe shkresa si përgjigje. Palët nuk kanë të drejtë të paraqesin dëshmi gojore derisa nuk ftohen të bëjnë një gjë të tillë, pasi që organizimi për pjesëmarrjen i disa mijëra paraqitësve të kërkesave do të shkaktonte harxhime të konsiderueshme të burimeve dhe humbje kohe, në këtë mënyrë do të ishte në kundërshtim me të drejtat e paraqitësve të kërkesave për mjete ligjore brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, fakti që paraqitësit e kërkesave janë të zhvendosur kudo nëpër Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe më larg, potencialisht do të rezultonte me atë që vetëm disa paraqitës të kërkesave do ta kishin të mundur të ushtronin të drejtën për të marrë pjesë në seanca dëgjimore. Megjithatë, duhet pasur parasysh se

aty ku interesi i drejtësisë do të kërkonte një gjë të tillë, KPPK-ja mund të mbajë seanca dëgjimore për të gjitha palët e përfshira, përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët.

Deri më tani, nuk është mbajtur asnjë seancë dëgjimore dhe të gjitha kërkesat të cilat kanë qenë ligjrisht jokontestuese, janë vendosur bazuar në dosjen e kërkesës duke ju referuar KPPK-së, e cila përmban dëshmitë dhe shkresat e paraqitësit të kërkesës, dëshmitë e mbledhura nga Sekretaria Ekzekutive dhe raportin mbi përpunimin e kërkesës.

Gjatë procesit të vendimmarrjes, kur KPPK-ja konstaton që i nevojiten informata shtesë për të vendosur mbi çështjet e ngritura nga kërkesa, mund t'ia kthejë kërkesën Sekretarisë Ekzekutive me urdhrin që të ndërmarr hetime shtesë në lidhje me kërkesën. Kjo zakonisht përfshinë verifikime shtesë dhe hulumtime për dokumente apo intervistimin e palëve në kërkesë.

Para se të vendos mbi kërkesën, KPPK-ja mund, me kërkesë të paraqitësit të kërkesës dhe me rekomandimin e Sekretarisë Ekzekutive, të aprovojë masa të përkohshme të mbrojtjes, përfshirë urdhrin të përkohshëm kur paraqitësi i kërkesës e ka dëshmuar prima facie kërkesën dhe nëse këto masa të përkohshme nuk do të aprovoheshin, do të balafaqeje me dëme të pandreqshme.

4.4 Natyra e Vendimeve

Komisioni mund të aprovtojë apo refuzojë kërkesën apo të lëshojë ndonjë vendim apo urdhrin i cili është i nevojshëm për t'i dhënë efekt ligjit në fuqi, përfshirë urdhrat për kthimin e të drejtave pronësore dhe riposedimin e pronës.

Kërkesa mund të refuzohet tërësisht apo pjesërisht në rastet kur:

- a. paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqesë kërkesë të plotë në përputhshmëri me procedurat e themeluara;
- b. kërkesa nuk është në kompetencë të AKP-së;
- c. kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë.

Vendimet e Komisionit janë ligjrisht detyruese, pa cënuar të drejtën e bërjes së ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, siç parashihet me legjislacionin në fuqi, i cili parasheh, gjithashtu, llojin e urdhrave

të cilët KPPK-së i lejohet t'i lëshojë. Në vendimin e saj KPPK-ja mund:

- të vendos të drejtat e tilla pronësore të cilat janë të nevojshme për zgjidhjen e kërkesës;
- të urdhërojë posedimin e pronës në favor të çdo pale; të refuzojë apo hedhë poshtë kërkesën për çdo arsye; apo
- të anulojë çdo marrëveshje mbi qiranë në lidhje me pronën, e cila është lëndë e urdhrit të lëshuar nga KPPK-ja, dhe të lëshojë urdhra ndihmës të cilët ndikojnë në këtë anulimin.

Kur kërkesa të jetë paraqitur nga anëtari i familjes së bartësit të së drejtës pronësore, KPPK-ja mund të vendos për çdo të drejtë pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore, dhe të urdhërojë ri-posedimin në favor të paraqitësit të kërkesës.

Në rastet kur ka bashkë-pronarë, vendimi i KPPK-së konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore në lidhje me pjesën përkatëse mbi të cilën ai gëzon të drejtën pronësore (p.sh. 1/2, 1/4, etj.), siç përcaktohet në dokumentet përkatëse të pronës të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës (d.m.th. Fleta Poseduese, Vendimi mbi Trashëgiminë, Vendimet e Gjykatës, etj). Në të gjitha rastet, vendimi i KPPK-së në mënyrë të qartë konfirmon që në rastet kur ka më shumë se një pronar, urdhri nuk ndikon në të drejtat e bashkë-pronarëve.

4.5 Forma e Vendimeve

Sipas legjislacionit në fuqi kërkohet që vendimet e KPPK-së të përmbajnë arsyetimin dhe të jenë me shkrim, duke cekur faktet materiale dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga KPPK-ja. Kërkohet që ato të jenë të nënshkruara nga Kryetari i KPPK-së dhe të përmbajnë detajet thelbësore si në vijim:

- datën e miratimit;
- emrat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- arsyet për vendimin (përfshirë faktet materiale dhe të drejtat pronësore, të cilat është konstatuar se ekzistojnë); dhe
- të përmend urëdhurat e KPPK-së.

Deri më tani, sa i përket marrjes së vendimeve, Legjislacioni në Fuqi parasheh që vendimet të merren në mënyrë unanime, por kur nuk mund të arrihet konsensus, kërkesa mund të vendoset me shumicë votash. Përveç kësaj, me qëllim që të lejohet zgjidhja e shpejt e kërkesave, KPPK-ja përdor metodat, të cilat i lejojnë të lëshojë një vendim për pakot me

kërkesat nga të cilat rrjedhin çështje të ngjashme ligjore, i njohur si "Vendim Grupor".

Kryetari duke nënshkruar Vendimin Grupor aprovon të gjitha vendimet individuale të identifikuara dhe regjistruara me numër të kërkesës në Vendimin Grupor. Gjatë periudhës së raportimit, KPPK-ja ka lëshuar 24 Vendime Grupore, duke përfshirë 4,423 kërkesa.

Kur kërkesa të jetë vendosur me Vendim Grupor, që të jetë e qartë për palët, përgatitet vendimi individual për secilën kërkesë i cili thekson detajet e pronës individuale të paraqitësit të kërkesës dhe ndihmën ligjore të aprovuar nga KPPK-ja. Vendimi individual i referohet Vendimit Grupor të KPPK-së dhe paragrafit të veçantë i cili thekson arsyet për vendimin sa i përket kërkesës.

4.6 Urdhërat dhe Mjetet Ligjore

Komisioni mund të aprovojë apo refuzojë kërkesën dhe është i kufizuar nga kriteret e themeluara në vendimet e veta, përveç nëse ekzistojnë arsye të cilat e detyrojnë të shmanget nga ato kriteret. Ai mund të caktojë vetëm mjetin ligjor i cili i ofrohet me legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të caktojë shpenzime të cilat rrjedhin nga procedura në favor, apo kundër ndonjë palë në procedurë.

KPPK-ja mund t'i referojë çështjet të cilat rrjedhin në lidhje me kërkesën, të cilat nuk janë në jurisdiksionin e tij, apo pjesë të veçanta të kërkesave të tilla, nëse vendimmarrja mbi ato pjesë të ndara nuk ngritë çështjet e pronësisë apo të drejtat e shfrytëzimit të pronës siç parashihet në legjislacionin në fuqi, në gjykatën kompetente vendore apo Gjykatën Administrative.

KPPK-ja ka përcaktuar në jurisprudencën e vet që nuk ka kompetencë të jap kompensim në të holla. Në rastet kur paraqitësit e kërkesa kërkojnë gjithashtu edhe kompensim për dëmin material, apo për shfrytëzim të paautorizuar të pronës së kërkuar, përveç konfirmimit të pronësisë, KPPK-ja ka refuzuar këtë aspekt të kërkesës duke mbajtur qëndrimin se nuk ka kompetencë të aprovojë një ndihmë të tillë ligjore.

KAPITULLI V

ZBATIMI

5.1 Hyrje

Sipas ligjit në fuqi, zbatimi efikas i vendimeve përfundimtare të Komisionit mbi kërkesat është arritur përmes masave që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: vendosjen e pronës nën administrimin e AKP-së, dëbimin, konfiskimin dhe demolimin e strukturave të paligjshme, ankandet dhe marrëveshjet mbi qiranë. Procedurat e zbatimit janë përmirësuar më tej dhe janë finalizuar gjatë periudhës së raportimit, por për shkak të mbylljes së zyrave të AKP-së në Serbi, dhe ndikimit të gabimeve të notifikimit, numri i vendimeve të shpërndara dhe të zbatuara ishte dukshëm më i vogël se objektivi i synuar në Planin e Punës së AKP-së. Zbatimi i vendimeve të KKKP-së është punë e Sekretarisë Ekzekutive, e cila kryhet nga Njësiti i Implementimit. Aktivitetet e zbatimit që përfshijnë dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm është punë që kryhet nga Njësiti i Dëbimeve të AKP-së.

5.2 Shpërndarja dhe zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

Procedura e shpërndarjes së vendimeve të KKKP-së, si shkalla e parë e procesit të zbatimit, përfshin Qendrën e Thirrjeve të AKP-së, e cila i kontakton me telefon paraqitësit e kërkesave për t'i informuar ata se vendimi është lëshuar dhe është në dispozicion të tyre, si dhe cakton takimin me ta për t'iu dorëzuar vendimet në zyrën e AKP-së, të cilën e preferon paraqitësi i kërkesës. Pas dorëzimit të vendimit, ekziston një afat prej 30 ditësh për ankesë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive, i cili afat fillon ditën që dorëzohet vendimi. Përveç kësaj, ky takim ofron mundësi për ta informuar paraqitësin e kërkesës me procesin e implementimit dhe për ta njoftuar paraqitësin e suksesshëm të kërkesës nëse, apo dhe si do të donin të zbatohet vendimi. Pas problemeve të notifikimit dhe ndërprerjes së lëshimit të vendimeve nga KKKP-ja siç është cekur më lart, shpërndarja e vendimeve është ndërprerë dhe numri i përgjithshëm i vendimeve të shpërndara në fakt është zvogëluar, sepse vendimet e bazuara në notifikimin e gabueshëm janë shfuqizuar. Deri në fund të periudhës së raportimit, AKP-ja ka shpërndarë 10,199 vendime për paraqitësit e kërkesave dhe 120 vendime për palët tjera të përfshirë në kërkesa.

Pasi që kërkesat e vendosura u janë shpërndarë paraqitësive të kërkesave, AKP-ja ka pranuar 5,106 kërkesa nga palët për ta vënë pronën e tyre nën administrim, 1,929 kërkesa për riposeditim dhe 1,073 kërkesa për mbyllje të rastit. Prej tyre, 4,707 kërkesa janë përpunuar, zbatuar dhe janë dërguar për mbyllje të rastit.

5.3 Zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore

AKP-ja ka, gjithashtu, mandat sipas ligjit në fuqi të zbatojë kërkesat pronësore banesore, të cilat kanë qenë në pritje më 4 mars 2006, dhe të menaxhojë dosjet e pronave të administruara nga DÇPB-ja. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të saj, AKP-së i janë dhënë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së.

5.4 Zbatimi i vendimeve në pritje të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

Në kohën e përpilimit të raportit, si dhe gjatë gjithë periudhës së raportimit, kanë mbetur 10 vendime të ish-KKKP-së në pritje të zbatimit në bazë të kërkesave të paraqitësve të suksesshëm të kërkesave për riposeditimin e pronës së tyre. Të gjitha këto prona gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës.

Përveç kësaj, ka pasur disa kërkesa të paraqitura në DÇPB dhe të vendosura nga KKKP-ja ku paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nuk kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në atë kohë, dhe DÇPB-ja i kishte mbyllur këto raste pa zbatimin fizik. Si pasojë, AKP-ja ka pranuar gjatë vitit 2009, gjithsej 24 kërkesa për riposeditim të paraqitura nga BDP-të apo nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Duke pasur parasysh se paraqitësive të kërkesave në të gjitha këto kërkesa kanë pasur të drejtë për dëbim sipas vendimit të KKKP-së, të gjitha këto kërkesa janë aprovuar. Në 15 raste prona është riposeduar nga paraqitësit e kërkesave, kurse për 9 rastet e mbetura procedura është duke vazhduar dhe vendimi i KKKP-së do të zbatohet në kohën e duhur.

5.5 Mbështetja e Aktiviteteve të Dëbimit të AKP-së nga Policia e Kosovës

Mbështetja e dhënë nga Policia e Kosovës (PK) për dëbimet është bërë përmes një MiM-je të nënshkruar në vitin 2006 në mes të Policisë së UNMIK-ut dhe AKP-së. Nga marsi i vitit 2009 PK-ja nuk kishte dhënë mbështetje për dëbimet në regjionin e Pejës në shumë raste, pastaj më vonë probleme të ngjashme ishin shfaqur edhe në regjionin e Gjilanit. Pas bisedimeve me ZQ-në e PK-së dhe me përkrahjen e EULEX-it, një MiM i ri ishte arritur dhe ishte nënshkruar më 19 tetor 2009. Kështu, problemi është zgjidhur dhe tani AKP-ja ndërmerr masat fillestare të dëbimit pa mbështetjen e policisë dhe PK-ja ofron mbështetje të plotë për aktivitetet tjera të dëbimeve.

5.6 Zbatimi i Skemës së Kompensimit

AKP-ja, si pasardhëse e DÇPB-së, është përgjegjëse për ndarjen dhe administrimin e skemës së kompensimit që ka të bëjë me pronat banesore shoqërore ku KKPB-ja ka konstatuar se bartësit të parë të së drejtës pronësore, për shkak të diskriminimit, nuk i është dhënë mundësia ta blejë pronën banesore në fjalë, dhe pastaj ajo i ishte ndarë një pale tjetër e cila pastaj e ka blerë atë. Një propozim për zbatimin e skemës ishte draftuar në vitin 2007 dhe duhej t'i paraqitej Bordit Mbikëqyrës sapo ai të formohej pas dorëheqjes së Kryetarit të atëhershëm.

Në vitet 2008 dhe 2009 Sekretaria Ekzekutive iu ka dërguar një kërkesë përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) që çështja e Skemës së Kompensimit të përfshihet në ligjin e ri të titulluar Ligji për Shitjen e Banesave, i cili ishte në shqyrtim që nga viti 2004. Megjithatë, përfaqësuesit e MMPH-së informuan se çështja e Skemës së Kompensimit nuk do të përfshihet në ligjin e propozuar sepse kjo me siguri do të vononte aprovimin e tij pasi që pagesa e kompensimit për ata që janë shpronësuar nga banesat kërkon rritje të konsiderueshme të buxhetit.

Sekretaria Ekzekutive ka rishikuar propozimin e saj për tu siguruar se legjislacioni i mundshëm që implementon Skemën e Kompensimit të ofrojë mundësi që bartësit e parë të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë mundur të ushtrojnë të drejtën e tyre të blerjes së banesës për shkak të diskriminimit, të trajtohen në të njëjtën mënyrë si ata persona që kanë të drejtë të blejnë banesë shoqërore sipas Ligjit të propozuar

për Shitjen e Banesave. Ata persona që më parë e kanë blerë banesën dhe do të shpronësohen nga prona e tyre nëse bartësit e parë të drejtës pronësore ushtrojnë të drejtën e tyre të blerjes së banesës, duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si ata persona që humbin pronën e tyre si rezultat i eksproprijimit. Ata bartës të parë të së drejtës pronësore të cilët nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre të blerjes së banesës kanë të drejtë për kompensim në mënyrë të ngjashme. Propozimi i rishikuar duhet t'i paraqitet Bordit Mbikëqyrës dhe më pas Qeverisë së Kosovës duke kërkuar që ligji të miratohet për të zbatuar Skemën e Kompensimit.

5.7 Mbyllja e Kërkesës

Pas përfundimit të zbatimit të kërkesës, kërkesa duhet të mbyllet dhe ky funksion kryhet nga Njësi i për Mbylljen e Kërkesave. Synimet e fazës së mbylljes janë që të sigurohet se mekanizmi i AKP-së, ashtu siç përcaktohet me ligjin e ri fuqi dhe me Procedurat Operative Standarde që aplikohen, përputhet me të gjitha fazat e përpunimit të kërkesës deri në zbatimin e kërkesave të vendosura. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur ka të bëjë me afatet dhe me një proces të duhur si dhe kur gabimet e gjetura paraqiten ashtu si duhet. Njësi i për Mbylljen e Kërkesave është themeluar në fillim të periudhës së raportimit dhe është bërë plotësisht operacional në prill të vitit 2009.

Në fund të periudhës së raportimit, janë mbyllur gjithsej 966 kërkesa, 658 prej tyre janë nga kategoria "Kërkesa të zbatuara në bazë të mosbashkëpunimit (paraqitësi i kërkesës është informuar mbi vendimin final)", 273 kërkesa i takojnë kategorisë "Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar mbyllje të rastit pa zbatim", pastaj 19 kërkesa janë nga kategoria: "Kërkesa të zbatuara nga NJAP" si dhe 16 prej tyre janë nga kategoria "Kërkesa të tërhequra". Numri i kërkesave të mbyllura, gjithashtu, është ndikuar negativisht nga problemi i notifikimit dhe mbyllja është pezulluar derisa të bëhet notifikimi pozitiv.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI I PRONËS DHE SKEMA E QIRADHËNIES VULLNETARE

6.1 Administrimi i Pronës Banesore

Rregulloret e UNMIK-ut: 1999/23 dhe 2000/60 autorizuan DÇPB-në që të vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm. Në mars të vitit 2006, AKP-ja duke marrë përgjegjësinë mbi operacionet e DÇPB-së mori edhe përgjegjësinë për menaxhimin e pronave që tashmë ishin nën administrim të DÇPB-së, si dhe për zbatimin e vazhdueshëm të skemës. Punët dhe detyrat lidhur me Administrimin e Pronave kryhen nga Njësi i Administrimit të Pronave i AKP-së.

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 autorizoi administrimin e pronave të braktisura banesore me qëllim të sigurimit të nevojave për strehim të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Gjithashtu, neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 autorizoi administrimin e pronës banesore në rrethana si në vijim:

- i. Me marrëveshjen midis palëve për zgjidhjen e kërkesës;
- ii. Me kërkesë të paraqitësit të kërkesës, pas vendimit të KKP-bë, i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës;
- iii. Pas dëbimit të uzurpuesit aktual, nëse paraqitësit e kërkesave kanë dështuar në riposelimin e pronës brenda 14 ditësh nga dita e njoftimit mbi zbatimin e dëbimit;
- iv. Kur nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pronën dhe prona ishte e lirë ose uzurpuesi aktual nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën; ose
- v. Kur nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pronën, me kërkesë të pronarit të pronës apo bartësit të së drejtës së banimit.

Me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, me të cilën është themeluar AKP-ja, mandati për administrimin e pronave banesore, që më parë e kishte DÇPB-ja, i ka kaluar AKP-së së bashku me autoritetin për të zbatuar administrimin e pronave.

Deri në fund të dhjetorit 2009, kishte 3,573 prona nën administrimin e AKP-së, prej të cilave 2,845 ishin vënë nën administrim me kërkesën e paraqitësve të suksesshëm të kërkesave paraqitur KKP-bë dhe

728 bazuar në intervenimin ex officio të AKP-së dhe paraardhësit të saj, DÇPB-së. Lidhur me këto 728 prona, është implementuar një strategji në prill 2009, për të identifikuar bartësit e të drejtës pronësore të pronave në fjalë dhe për t'iu mundësuar atyre që të marrin kontrollin mbi pronat e tyre.

6.2 Skema e Qiradhënies Vullnetare

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh që skema e qiradhënies të zbatohet për pronat që janë nën administrim, ku parat e mbledhura nga qiraja për pronën nën administrim do të vireshin në një llogari të posaçme mirëbesimi për pronarin e ligjshëm. Një skemë e tillë e qirasë ishte propozuar gjatë kohës së funksionimit të DÇPB-së, por për shkak të natyrës së ndjeshme politike të kësaj çështjeje, Skema mori aprovimin e nevojshëm politik tek në gusht të vitit 2006 dhe u bë e zbatueshme në tetor të vitit 2006.

Skema shërben për të ofruar mbrojtje ligjore dhe fizike për pronën e braktisur banesore duke siguruar burim minimal të të ardhurave për bartësit e të drejtës pronësore, të cilët përndryshe mund të vendosin të shesin shtëpitë e tyre.

Me një vlerësim të favorshëm të kushteve dhe të përshatshmërisë së pronës për ta përfshirë atë në Skemën e Qiradhënies dhe me pajtimin e bartësit të së drejtës pronësore, AKP-ja do të provojë që ta lëshojë me qira pronën përmes një marrëveshjeje me palën e tretë. Nëse lokalet nuk lëshohen me qira nuk do të ketë pagesë të qirasë, por nëse pala e tretë pajtohet që ta marrë me qira pronën, atëherë AKP-ja e merr qiranë në baza mujore dhe ia dorëzon atë bartësit të së drejtës pronësore minus 5% për shpenzime administrative. Në rastet se qiraja nuk paguhet, AKP-ja mund ta dëbojë banorin. AKP-ja merr paradhënie nga qiramarrësi për të mbuluar ndonjë qira të papaguar ose ndonjë dëmtim të pronës nëse qiramarrësi është përgjegjës për këtë dëmtim. Pjesa e mbetur e paradhënies do t'i kthehet qiramarrësit pas përfundimit të marrëveshjes dhe pas inspektimit të pronës.

Skema e Qiradhënies Vullnetare është zgjeruar për të përfshirë edhe dhënie me qira të pronave bu-

jqësore dhe komerciale përveç pronave banesore. Megjithatë, ka disa përjashtime, siç janë pyjet, që nuk mund të përfshihen në këtë Skemë.

6.2.1 Natyra dhe numri i pronave në Skemën e Qiradhënies

Deri në fund të periudhës së raportimit, gjithsejt 932 prona janë përfshirë në Skemën e Qiradhënies. Nga numri i përgjithshëm i pronave nën administrimin e AKP-së, 368 prona janë identifikuar si të papërshtatshme për t'i përfshirë në Skemën e Qiradhënies për shkak të lokacionit të tyre ose për shkak të kushteve të këqija.

Shuma prej €1,733,889 është mbledhur nga qiraja dhe paradhënia deri në fund të periudhës së raportimit, prej tyre € 1,235,289 iu janë transferuar pronarëve dhe €417,957 janë mbajtur si paradhënie në fondin e mirëbesimit. Shuma prej €61,764 është rezervuar për shpenzime administrative të zbatimit të Skemës (e barabartë me 5% të qirasë së mbledhur /jo paradhënies). Shuma e paradhënies që i është kthyer banorëve është € 18,879.

Banori, i cili nuk dëshiron të paguajë qiranë ose nuk e paguan më qiranë ka 30 ditë afat për ta lëshuar pronën. AKP-ja e zbaton dëbimin pasi të ketë kaluar afati prej 30 ditësh, nëse banori nuk e ka liruar pronën vullnetarisht. Pas lirimit të pronës ajo mund t'i lëshohet me qira ndonjë qiramarrësi tjetër. Kur prona nuk është e dëmtuar, qiramarrësit të dëbuar i kthehet paradhënia e tij/saj. Gjatë periudhës së raportimit rreth 1,832 qiramarrës të pronave në Skemën e Qiradhënies janë dëbuar për shkak të mospagesës së qirasë, ose për shkak të riuzurpimit të paligjshëm të pronave.

6.2.2 Zbatimi i Skemës së Qiradhënies

Pas nënshkrimit të MiM me PK më 19 tetor 2009, zbatimi i Skemës së Qiradhënies është rritur dukshëm. Procedura e re, e cila është implementuar, është e tillë që personeli Regjional i AKP-së të bëjë dëbimin e parë pa mbështetjen e policisë. Dëbimi i parë përfshinë dhënien e vërejtjes së fundit që informon banorët që, ose duhet ta paguajnë qiranë sipas kontratës mbi qiradhënien, ose ta lirojnë pronën brenda afatit të dhënë. Ditën kur kalon afati i dhënë, personeli Regjional i AKP-së kthehet në pronë, ose për të bërë dëbimin ose në rast të lirimit vullnetar, ta sigurojë pronën. Në rastet kur banori refuzon ta lirojë pronën, planifikohet dëbimi me mbështetjen e policisë. Kur të planifikohen këto dëbime më nuk mund të anulohen përveç në rrethana të veçanta dhe vetëm me miratimin e Drejtorit apo Zv. Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së. Prej tetorit 2009 e këtej, Njësi i Dëbimeve ka planifikuar afro 60 dëbime në javë, vetëm të AKP-së, dhe prej tyre mbi 50% e dëbimeve janë anuluar për shkak se është paguar qiraja.

Nënshkrimi i MiM, gjithashtu, ka ngritur çështjen e pazgjidhur për një kohë të gjatë të dëbimeve në pjesën veriore të Mitrovicës, që nuk janë kryer edhe pse janë planifikuar nga AKP-ja, për shkak se nuk kishte mbështetje nga Policia e UNMIK-ut. Në këto raste një numër i madh i uzurpuesve kanë pranuar të paguajnë qiranë për pronat të cilat i shfrytëzojnë ose kanë paraqitur dëshmi që tregojnë se ata e kanë zgjidhur çështjen e shfrytëzimit të pronës me bartësin paraprak të së drejtës pronësore apo pronarin gjatë periudhës së intervenimit.

KAPITULLI VII

PERSONELI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

7.1 Burimet Njerëzore

Gjithë përgjegjësinë për personelin dhe për aftësimin profesional e mbajnë Burimet Njerëzore të AKP-së.

Pasqyra e personelit të AKP-së është si më poshtë:

- Personeli në vijim paguhet nga donacionet e ofruara nga autoriteti donator që është paraqitur në shtyllën e parë, pra si i tillë nuk paguhet nga mjetet buxhetore të AKP-së:

Autoriteti donator	Numri i Personelit Ndërkombëtar	Numri i Personelit Vendor
ICO/EULEX	4	3
Qeveria Norvegjeze	1	

- Personeli në vijim ka kontratë me AKP-në dhe si i tillë paguhet nga buxheti i AKP-së:

Autoriteti donator	Numri i Personelit Ndërkombëtar	Numri i Personelit Vendor
Fondi i Donatorëve	8	177 (prej tyre 12 në Serbi, 1 në Mal të Zi)
BKK		72

	Numri i Personelit Ndërkombëtar	Numri i Personelit Vendor
GJITHSEJ	13	255

Menaxhmenti i AKP-së është ekip i përzier i ndërkombëtarëve që mbajnë 20 % të posteve udhëheqëse dhe vendorëve që mbajnë 80 % të posteve udhëheqëse, duke udhëhequr Njësitë të ndryshme të AKP-së nëpër Kosovë. Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja ka punësuar rreth 255 profesionalistë dhe personel tjetër duke përfshirë: juristë, asistentë juridikë, përkthyes, kontabilistë, ekspertë për kompjuter dhe TI, dhe personel tjetër mbështetës administrativ.

AKP-ja ka një personel shtesë prej 72 shërbyesve civilë, të cilët paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), kushtet dhe kriteret e pozitive të tyre si dhe paga janë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës (të ndryshuar), Urdhëresat dhe Udhëzimet Administrative që zbatojnë legjislacionin në fjalë. Pas skadimit të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, AKP-ja ka lëshuar kontrata për personelin vendor, për ata punëtorë të cilët më parë kanë pasur kontratë të UNOPS-it. Në pajtim me ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me tatimet dhe pensionet, AKP-ja zbrit një shumë të caktuar nga paga bruto e punëtorëve me të cilën e paguan në Administratën Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Kosovës dhe Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës siç është e përshtatshme. Sa i përket personelit vendor në Serbi, ata kanë kontrata të këshilltarëve dhe statusi i tati- meve dhe pensioneve të këtyre punëtorëve ka mbetur të zgjidhet mes tyre dhe institucioneve të tyre.

Punëtorëve ndërkombëtarë të cilët më parë kanë pasur kontratë me UNOPS-in, fillimisht i u janë ofruar kontrata të këshilltarëve, megjithatë për shkak të natyrës së punës që kryejnë disa nga këta punëtorë, nevoja për t'i u dhënë atyre privilegje dhe imunitet ishte çështje që duhej shqyrtuar. Kjo çështje u zgjidh me nënshkrimin e marrëveshjes mes Ministrit të Ekonomisë dhe Financave në emër të AKP-së dhe UNDP-së, të cilët pastaj bënë një marrëveshje të veçantë me UNOPS-in për t'i ofruar AKP-së, gjashtë punëtorë ndërkombëtarë, dhe kjo marrëveshje hyri në fuqi në mars të vitit 2009.

Përveç personelit ndërkombëtar të lartpërmendur, AKP-së i janë dërguar dy punëtorë UNV përmes UNDP-së. ICO-ja ka dërguar Drejtorin Ekzekutiv kurse EULEX-i ka dërguar dy Komisionerë Ndërkombëtarë dhe Udhëheqësin e Zyrës së KKP-së, kurse një punëtor tjetër ndërkombëtar është dërguar nga Qeveria e Norvegjisë.

Pas miratimit të Ligjit 03/L-079 i gjithë personeli vendor i AKP-së, përfshirë personelin me BKK, kanë mundësi të marrin pjesë në trajnime të cilat organizohen Instituti Kosovar i Administratës Publike. Disa punëtorëve u është ofruar mundësia dhe e

kanë shfrytëzuar atë mundësi për të rritur aftësitë e tyre profesionale duke ndjekur këto trajnime. Përveç kësaj, zyra e BN në AKP ka krijuar Politikën e Trajnimit të Jashtëm e cila ofron një procedurë që punëtorët të aplikojnë për trajnime të jashme, të cilat nëse aprovohen ofrojnë mbështetje të kufizuar financiare për punëtorin që do ta ndjekë trajnimin e zgjedhur. Kjo gjithashtu ofron qasje të njëjtë në trajnime dhe mundësi për aftësim personal për të gjithë punëtorët e AKP-së.

Megjithëse AKP-ja përdorë teknologji moderne gjithpërfshirëse, duke kompjuterizuar përpunimin e kërkesave, prapëseprapë ajo varet shumë nga njohuritë njerëzore dhe në këtë aspekt personeli i AKP-së përfaqëson shtyllën e Agjencisë. Janë zhvilluar ekspertiza të rëndësishme në fushën e kthimit të pronave gjatë disa viteve duke filluar nga paraardhësi i AKP-së, DÇPB-ja, pjesa më e madhe e personelit të së cilës janë transferuar në AKP, pas mbylljes së DÇPB-së, për të mbajtur aftësitë e tyre institucionale dhe profesionale. Është e rëndësishme që AKP-ja të ketë burime të vazhdueshme që të mbajë personelin me përvojë dhe profesionalizëm të rëndësishëm.

7.2 Menaxhmenti dhe Personeli

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së udhëhiqet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, të cilët mbështeten drejtpërsëdrejti nga personeli i Zyrës Ekzekutive. Njësitë kryesore operacionale të AKP-së, që kanë të bëjnë me përpunimin dhe zbatimin e kërkesave janë: Zyrat Regjionale që menaxhohen nga Kordinatori Regjional: Njësi i Informimit; Njësi i Verifikimit të Dokumenteve; Njësi për Përpunimin e Kërkesave; Zyra e KKPb-së; Njësi i Implemetimit; Njësi i Administrimit të Pronave; dhe Njësi i Dëbimeve. Punët dhe përgjegjësitë e këtyre njësive janë përshkruar më lart në këtë raport. Megjithatë, ka njësive të tjera që edhe pse nuk janë drejtpërdrejt të përfshira në përpunimin dhe zbatimin e kërkesave, gjithashtu luajnë një rol përbërës dhe të rëndësishëm në AKP. Njësi i Administrimit i AKP-së ofron mbështetjen logjistike, shërbimet e transportit, menaxhimin e ndërtesës, shërbimet e sigurimit, menaxhimin e aseteve, shërbimet e furnizimit dhe arkivimit për ZQ-në e AKP-së dhe Zyrat Regjionale.

AKP-ja përdorë teknologji moderne gjithpërfshirëse, dhe përpunimi i kërkesave është mjaft i kompjuterizuar. Njësi i TI është përgjegjës për të ofruar mbështetje të përgjithshme teknike dhe të mbajë stabil mjedisin elektronik të punës. Për të lehtësuar përpunimin e kërkesave, menaxhimi i të dhënave dhe zhvillimi i aplikacioneve bëhet në bashkëpunim me shfrytëzuesin e fundit si dhe zhvillimi dhe azhurimi i aplikacioneve bëhet përmes identifikimit dhe përdorimit të teknologjive të reja. Trajnimi i personelit mbi përdorimin e aplikacioneve dhe paisjeve të softuerit gjithashtu bëhet nga Njësi i TI-së.

Njësi i Auditimit të Brendshëm i AKP-së është përgjegjës për të ofruar menaxhim të lartë dhe për të siguruar që sistemet e kontrollit të menaxhimit që aplikohen në AKP të jenë adekuate dhe të veprojnë në mënyrë efektive. Auditimi i brendshëm jep vlerësim të pavarur dhe objektiv mbi aktivitetet e Njësive që i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe iu jep menaxhetëve të Njësive analiza, rekomandime këshilla dhe informata lidhur me aktivitetet e shqyrtuara. Kjo përfshinë promovimin e kontrolleve efektive me çmim të arsyeshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm kryen një varg shërbimesh të auditimit përfshirë edhe auditimet financiare, auditimet e përputhshmërisë, auditimet operacionale, auditimet e teknologjisë informative, si dhe shërbime këshilluese.

Njësi i Përkthimeve i AKP-së punon në bashkëpunim me asistentët e përkthimit të sjellur nga EULEX-i, të cilët janë të dedikuar për punën e KKPb-së, dhe ofron shërbimet e përkthimeve me shkrim dhe me gojë për AKP-në. Kjo përfshinë vendimet e KKPb-së, memorandumet dhe korrespondencën të ndryshme, raporte dhe çdo përkthim tjetër që nevojitet brenda mandatit të AKP-së.

Zyra e Prokurimit e AKP-së ndërmerr të gjitha aktivitetet e prokurimit që kërkohen nga AKP-ja sipas Ligjit No. 02/L-99 për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik në Kosovë. Gjatë vitit 2009, Zyra e Prokurimit ka kryer me sukses 84 prokurime gjithsej dhe ka bërë vazhdimin e 7 kontratave nga prokurimet e mëparshme.

KAPITULLI VIII

FINANCIMI DHE BUXHETI

8.1 Financimi

Çështjet buxhetore dhe financiare të AKP-së janë përgjegjësi e Njësitit të Financave të AKP-së. Financimi ka vazhduar të jetë problem për AKP-në gjatë vitit 2009 me shkurtimet e parapara të fondeve që vazhdimisht shqetësojnë institucionin. Edhe pse AKP-ja ka mandat të përbushë një nga funksionet kryesore të sundimit të ligjit në Kosovë, megjithatë nga institucioni kërkohet të sigurojë pjesën më të madhe të nevojave financiare nga kontributet vullnetare të donatorëve, për ndryshim nga veprimtaritë tjera qeveritare të cilat kanë financim qendror.

Gjatë periudhës së raportimit, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës janë paguar vetëm 26% të buxhetit të përgjithshëm, rreth 1,043,107€ nga 3,962,005€ sa ishte shuma e përgjithshme e kërkesave buxhetore të AKP-së. Në periudhën e raportimit, megjithatë, pati premtime nga donatorë të rinjë dhe ata aktualë për buxhetin e AKP-së. Pagesa e fundit nga kontributi për vitin 2008 në vlerë prej 10,000€ nga Qeveria Belgje, pritet të merret së shpejti. AKP-ja ka kërkuar që pjesa e mbetur prej 10,000€ e destinuar për botimin e Gazetës së AKP-së të bartet në vitin 2010. Qeveria Belgje gjithashtu është duke e shqyrtuar një projekt propozim për të mbështetur aktivitetet e informimit të AKP-së që veçanërisht kanë për objektiv skemën vullnetare të qiradhënies me një shumë prej 48,450€.

Qeveria Gjermane gjithashtu ka ofruar 477,925€ që të shfrytëzohen deri në fund të shkurtit 2009, prej tyre është shpenzuar vetëm shuma prej 312,855€ deri në fund të shkurtit 2009, dhe ndryshimi prej 165,070€ i është kthyer Qeverisë Gjermane sipas kontratës. Qeveria Norvegjeze ka ofruar 235,433€ apo 2 milion NOK në dhjetor 2009 që duhet të shfrytëzohen në vitin 2010. Ambasada Norvegjeze në Prishtinë gjithashtu ka mbështetur financiarisht AKP-në lidhur me përmirësimin e ueb hartës së AKP-së, sistemit të përcjelljes së veturave dhe me ofrimin e aparateve bashkëkohore GPS, të gjitha këto në mbështetje të zgjidhjes së problemeve të identifikuar me notifikimin e kërkesave.

Një shumë prej 730,457€ që përbënë pjesën e parë të kontributit të Qeverisë Suedeze për periudhën 2009-2010 prej gjithsejt 15 milion SEK, është marrë në nëntor të vitit 2008. Pjesa e dytë prej 666,679€ është marrë pas aprovimit të raportit të auditimit mbi shpenzimet e pjesës së parë të paguar, dhe pjesërisht do të shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet e vitit 2010. Shuma prej 299,949 që përbën pjesën e parë të kontributit të Qeverisë Zvicerane për periudhën 2009-2010 prej gjithsejt 1 milion€ është marrë në dhjetor të vitit 2008. Pjesa e dytë prej 379,990€ është paguar pas miratimit të raportit të përkohshëm dhe raportit të auditimit për fondin zviceran për vitin 2008, dhe pjesa e fundit prej 50,000CHF nga marrëveshja për vitin 2006-2008 që ishte gjithashtu në pritje të këtyre raporteve pritet të merret në kohën e duhur.

Qeveria Britanike ka ofruar 547,024€ për buxhetin gjatë periudhës së raportimit. Prej tyre, 369,104€ janë transferuar përmes pjesës së parë të marrëveshjes dhe janë shfrytëzuar për të mbuluar shpenzimet e tremujorit të fundit të vitit 2009, ndërsa pjesa e dytë dhe e fundit prej 177,920€ do të merret në vitin 2010 për t'i mbuluar shpenzimet e AKP-së për tremujorin e parë të vitit 2010. Kontributet e pranura nga Qeveria e SHBA-së gjatë vitit 2009 kanë qenë 514,212€.

8.2 Implementimi i Buxhetit

I bashkëngjitur si Aneksi C është Buxheti i AKP-së për vitin 2009 i cili është ndarë si në vijim:

Paga dhe Mëditje: 2,458,051
Mallra dhe Shërbime*: 1,171,119
Shërbime komunale: 105,000
Investime Kapitale: 100,000

Gjithsej:
3,834,171

(*pagat e të gjithë personelit vendor, që nuk janë me BKK paguhen nga kjo kategori ekonomike)

Pas rishikimit të buxhetit gjashtëmuor, AKP-ja ka ndryshuar buxhetin për të pasqyruar ndryshimet që janë bërë gjatë procesit të ri-alokimit dhe kjo është e bashkëngjitur si Aneksi D me shumatat e rishikuara:

Paga dhe Mëditje: 2,453,138
Mallra dhe Shërbime*: 945,569
Shërbime komunale: 105,000
Investime Kapitale: 37,700

Gjithsej:
3,541,408

(*pagat e të gjithë personelit vendor që nuk janë me BKK paguhen nga kjo kategori ekonomike)

E bashkëngjitur si Aneksi E është pasqyra e Buxhetit të AKP-së për vitin 2009 e cila pasqyron si është shpenzuar Buxheti. Si përmbledhje, shuma e përgjithshme e përvetësuar nga BKK për vitin 2009 ishte 1,043,107€, prej tyre 928,769€ janë shpenzuar. Shuma e mbetur prej 114,338.12 ka skaduar dhe fondet janë mbajtur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Shuma e donacioneve ishte 2,918,898€, prej tyre 2,219,851.55€ janë shpenzuar. Shuma e mbetur prej 530,294.40€ të destinuar nga donatorët për AKP-në është mbajtur dhe ka kaluar në vitin fiskal 2010.

Përqindja e shpenzimeve nga mjetet e ndara nga buxheti i BKK-së ishte 89.04% dhe arsyeja kryesore për këtë ishte kërkesa e donatorëve të AKP-së që të zvogëlohen shpenzimet nga Buxheti i Kosovës për Mallra dhe Shërbime dhe një shpenzim dukshëm më i vogël për shërbimet komunale. Sa i përket fondëve të donatorëve përqindja e shpenzimeve ishte 76.05% që kryesisht i atribuohet kërkesës për t'i financuar Zyrat e AKP-së në Serbi në mënyrë që ato të jenë të gatshme për punën e tyre, gjë e cila nuk ka ndodhur.

KAPITULLI IX

AKTIVITETET PËR INFORMIM DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE PUBLIKE

9.1 Transparenca dhe Informimi

Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ka ndërmarrë disa iniciativa për të qenë më afër palëve në kërkesa, OJQ-ve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare dhe publikut në tërësi.

Gjatë muajve të parë të periudhës së raportimit, AKP-ja bëri një fushatë për qiranë nëpër media me qëllim të promovimit të Skemës së Qiradhënies Vullnetare dhe pronave nën administrimin e AKP-së të cilat janë në dispozicion për t'u lëshuar me qira. Përveç kësaj afro 40,000 fletushka informative janë shtypur dhe janë shpërndarë gjatë periudhës së raportimit.

AKP-ja gjithashtu ka organizuar një sërë takimesh informative me përfaqësuesit e trembëdhjetë komunave, të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat Regjionale të AKP-së. Qëllimi i këtyre takimeve ishte për të informuar përfaqësuesit komunalë mbi mandatin dhe punën që kryen AKP-ja, për të shqyrtuar ndonjë çështje apo problem si dhe për të diskutuar për sfidat në të ardhmen. Komunat janë zgjedhur në bazë të numrit të kërkesave të paraqitura në AKP për prona në komuna të ndryshme.

AKP-ja gjithashtu vazhdon të ketë shërbimet e veta të Qendrës së Thirrjeve dhe linjën telefonike të dedikuar për informata si dhe e-mailin (mailbox@kpaonline.org) që palët të mund të informohen shpejt mbi statusin aktual të kërkesave të tyre, dhe të marrin informacione mbi procesin dhe procedurat që zhvillohen në AKP.

Agjencia gjithashtu vazhdon të ketë ueb-faqen (www.kpaonline.org) për kërkesat e AKP-së në mënyrë që të ofrojë një numër të madh të informacioneve dhe statistikave në lidhje me aktivitetet e saj, gjegjësisht për pranimin e kërkesave, vendimmarrjen mbi kërkesat nga ana e Komisionit, shpërndarjen dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit, menaxhimin e dosjeve të Pronave nën Administrim dhe Skemën e Qiradhënies.

Gjatë vitit, AKP-ja ka vazhduar të jetë prezente në media. Përfaqësuesit nga AKP-ja kanë marrë pjesë në intervista në gazeta, radio dhe televizion si dhe në konferenca për shtyp në lidhje me çështjet pronësore. Gjithashtu AKP-ja rregullisht u ofron mediave informata dhe statistika të azhuruara për aktivitetet dhe politikat e saj, përmes Njësitit të Informimit.

9.2 Bashkëpunimi në mes Agjencive

Në përpjekje për t'iu ofruar informacione institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, AKP-ja është takuar rregullisht me akterët tjerë në fushën e të drejtave pronësore me qëllim të ngritjes së vetëdijes për punën e saj dhe lidhjen e saj me ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Këtu përfshihen në mes tjerash edhe UNHCR-ja; OSBE-ja dhe OJQ-të e ndryshme. AKP-ja është takuar gjithashtu me zyrtarë të Qeverisë së Kosovës. Përveç kësaj AKP-ja rregullisht i ka ndjekur dhe ka marrë pjesë në takime, punëtori dhe nëpër seminare në Kosovë, të cilat janë organizuar nga organizatat dhe nga OJQ-të e përfshira në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe me procesin e kthimit.

NGJARJET KRYESORE GJATË VITIT 2009

- Në shkurt Qeveria Amerikane i dhuroi AKP-së 300,000\$.
- Në mars PCN emëroi Veijo Heiskanen si Kryetar të KKPK-së dhe Norbert Wühler si anëtar ndërkombëtar të KKPK-së.
- Në mars Kuvendi i Kosovës emëroi Adem Vokshin si anëtar vendor të KKPK-së.
- Në prill u mbajt seanca e njëmbëdhjetë e KKPK-së ku u vendos mbi 504 kërkesa.
- Në qershor u mbajt seanca e dymbëdhjetë e KKPK-së ku u vendos mbi 2.477 kërkesa.
- Në korrik u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
- Në korrik Qeveria Amerikane i dhuroi AKP-së 400,000\$.
- Në gusht u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit me UNHCR.
- Në gusht u mbajt seanca e trembëdhjetë e KKPK-së ku u vendos mbi 859 kërkesa.
- Në tetor Qeveria Britanike dhuroi 500,000£ për buxhetin e AKP-së.
- Në tetor u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit me Policinë e Kosovës.
- Në nëntor Qeveria Norvegjeze i dhuroi AKP-së 19 GPS-a.
- Në dhjetor u mbajt seanca e katërbëdhjetë e KKPK-së ku u vendos mbi 583 kërkesa.
- Në dhjetor Kuvendi i Kosovës aprovoi buxhetin për AKP-në nga BKK-ja për vitin 2010 në vlerë prej 1,321,131€.
- Në dhjetor Qeveria Norvegjeze i dhuroi AKP-së 2 milion NOK.

Aneksi A – Pasqyra e rrjedhës së përpunimit të kërkesave

Aneksi B – Statistikat mbi vendimmarrjen e kërkesave

STATISTIKAT MBI VENDOSJEN E KËRKESAVE DERI NË DHJETOR 2009

2007-2009	Seanca e KPCC-së	Nr. i kërkesave të referuara Komisionit	Kërkesat e vendosura	Kërkesat e kthyer Sekretarisë	
				Numrat	% e kërkesave të referuara
Qershor/7	Seanca e 1 ^{rë}	955	498	457	48
Gusht /07	Seanca e 2 ^{të}	1179	487	692	59
Tetor/07	Seanca e 3 ^{të}	544	528	16	2.9
Dhjetor/07	Seanca e 4 ^{të}	1863	1833	30	1.6
Shkurt/08	Seanca e 5 ^{të}	2415	2403	12	0.5
Prill/08	Seanca e 6 ^{të}	2617	2586	31	1.18
Qershor/08	Seanca e 7 ^{të}	2880	2850	30	0.87
Gusht/08	Seanca e 8 ^{të}	3050	2920	130	4.26
Tetor/08	Seanca e 9 ^{të}	2621	2594	28	1.07
Dhjetor/08	Seanca e 10 ^{të}	2190	2140	50	2.34
Prill/09	Seanca e 11 ^{rë}	512	504	8	1.5
Qershor/09	Seanca e 12 ^{të}	2520	2477	43	1.0
Gusht/09	Seanca e 13 ^{të}	1094	859	235	21.4
Dhjetor/09	Seanca e 14 ^{të}	619	583	36	0.58
Totali			23,262		
		Minus vendime të shfuqizuara	743		
		Numri i Përgjithshëm	22,519		

Kategoria e kërkesave	Numri i kërkesave të vendosura
Tokë Bujqësore	22,033
Pronë Komerciale	20
Pronë Banesore	1209
Vendime të shfuqizuara të KPCC-së	743
Numri i Përgjithshëm	22,519¹

¹ Vëreni se KPCC-ja tani i ka shfuqizuar vendimet në lidhje me 743 kërkesat në vijim;

Aneksi C – Buxheti i AKP-së për vitin 2009

Pasqyra Buxhetore e AKP-së për vitin 2009

Shpenzimet e planifikuara	Kërkesa buxhetore (€)	Burimi i kërkuar i fondeve	Zotimi (€)	Zotimi nga	Pjesa e mbetur (€)
Shpenzimet e personelit (duke përjashtuar kontributin në natyrë për 7 punëtorë ndërkombëtarë dhe 5 punëtorë vendor)	2,521,196		2,071,520		449,676
Totali për Personelin Ndërkombëtar	754,928.83		754,928.83	Donatorë	0.00
Pagat e Personelit Ndërkombëtar	754,928.83	Donatorë	754,928.83		0.00
Totali për Personelin Vendor në Kosovë	1,438,609.04		1,062,304.80	Donatorë	376,304.24
Pagat e Personelit Vendor në Kosovë	1,310,275.24	Donatorë	958,490.50	BKK	351,784.74
Personeli vendor në Kosovë – kontributi pensional (5% e pagës së përgjithshme)	69,487.00	BKK	69,487.00	Donatorë	0.00
Sigurimi shëndetësor i personelit vendor në Kosovë	58,846.80	Donatorë	34327.30		24,519.50
Totali për Personelin Vendor jashtë Kosovës	116,880.90		97,509.20	Donatorë	19,371.70
Pagat e personelit vendor jashtë Kosovës	107,176.50	Donatorë	89,154.50	Donatorë	18,022.00
Sigurimi shëndetësor i personelit vendor jashtë Kosovës	4,297.80	Donatorë	4,095.00	Donatorë	202.80
Kontributi pensional për personelin vendor jashtë Kosovës(5%)	5,406.60	Donatorë	4,259.70	BKK	1,146.90
Personeli i BKK-së (kontributi pensional&pagesa për rrezikshmëri në punë)	210,777.00		156,777.00		54,000.00
Personeli i BKK-së në Kosovë (72) (përfshirë kontributin pensional)	156,777.00	BKK	156,777.00	BKK	0.00
rrezikshmërinë e punës në terren e personelit të BKK)	54,000.00	BKK	0.00	Donator	54,000.00
Mallrat dhe Shërbimet	1,007,975.00		848,975.00		159,000.00
Mallrat dhe Shërbimet në Kosovë	820,000.00	BKK	661,000.00	BKK	159,000.00
Mallrat dhe Shërbimet në Maqedoni Mal të Zi	10,800.00	BKK	10,800.00	Donatorë	0.00
Mallrat dhe Shërbimet në Serbi	62,760.00	BKK	62,760.00	Donatorë	0.00
Shpenzimet e qirasë për veturat në Serbi	12,000.00	Donatorë	12,000.00	Donatorë	0.00
Ri- regjistrimi i 25 veturave në Kosovë	4,713.00	BKK	4,713.00	Donatorë	0.00
Shpenzimet për sigurimin e veturave me tabela të UNOPS-it	6,702.00	BKK	6,702.00	Donatorë	0.00
Pagesa e shpenzimeve të qirasë për ZR në Prishtinë	30,000.00	BKK	30,000.00	Donatorë	0.00
Pagesa e shpenzimeve të qirasë për ZR në Prizren	18,000.00	BKK	18,000.00	BKK	0.00
Pagesa e shpenzimeve të qirasë për ZR në Mitrovicë	18,000.00	BKK	18,000.00	BKK	0.00
Shpenzimet tjera të transp.(ndërrimi i zyrave, 2 gjeneratorë)	25,000.00	BKK	25,000.00	Donatorë	0.00
Shërbimet Komunale	105,000.00		105,000.00		0.00
Shërbimet Komunale në Kosovë	105,000.00	BKK	105,000.00	BKK	0.00
Investimet kapitale	100,000.00				100,000.00
Investimet kapitale	100,000.00	BKK	0.00		100,000.00
Aktivitetet e informimit publik	100,000.00		0.00		100,000.00
Aktivitetet e informimit publik	100,000.00	BKK	0.00		100,000.00
Fondi i përgjithshëm i BKK-së	1,581,239.00		1,028,264.00		552,975.00
Fondi i përgjithshëm i donatorëve	2,252,931.77		1,997,230.83		255,700.94

Aneksi D – Buxheti i ndryshuar i AKP-së pas rishikimit të buxhetit të gjashtëmuorit

Pasqyra Buxhetore e AKP-së për 2009

Shpenzimet e planifikuara	Kërkesa buxhetore (€)	Burimi i kërkuar i fondeve	Zotimi (€)	Zotimi nga	Pjesa e mbetur (€)
Shpenzimet e personelit (duke përfshirë kontributin në natyrë për 7 punëtorë ndërkombëtarë dhe 5 punëtorë vendor)	2,516,283		2,081,363		434,920.06
Totali për Personelin Ndërkombëtar	754,928.83		754,928.83		0.00
Pagat e Personelit Ndërkombëtar	754,928.83	Donatorë	754,928.83	Donatorë	0.00
Totali për Personelin Vendor në Kosovë	1,477,853.16		1,062,304.80		415,548.36
Pagat e Personelit Vendor në Kosovë	1,349,519.36	Donatorë	958,490.50	Donatorë	391,028.86
Personeli vendor në Kosovë – kontributi pensional (5% e pagës së përgjithshme)	69,487.00	BKK	69,487.00	BKK	0.00
Sigurimi shëndetësor i personelit vendor në Kosovë	58,846.80	Donatorë	34327.30	Donatorë	24,519.50
Totali për Personelin Vendor jashtë Kosovës	116,880.90		97,509.20		19,371.70
Pagat e personelit vendor jashtë Kosovës	107,176.50	Donatorë	89,154.50	Donatorë	18,022.00
Sigurimi shëndetësor i personelit vendor jashtë Kosovës	4,297.80	Donatorë	4,095.00	Donatorë	202.80
Kontributi pensional për Personelin Vendorë jashtë Kosovës(5%)	5,406.60	Donatorë	4,259.70	Donatorë	1,146.90
Personeli i BKK-së në Kosovë (72) (përfshirë kontributin pensional)	166,620.00	BKK	166,620.00	BKK	0.00
Mallrat dhe Shërbimet	823,975.00		823,975.00		0.00
Mallrat dhe Shërbimet në Kosovë	702,000.00	KCB	702,000.00	KCB	0.00
Mallrat dhe Shërbimet në Maqedoni Mal të Zi	10,800.00	KCB	10,800.00	Donatorë	0.00
Mallrat dhe Shërbimet në Serbi	62,760.00	KCB	62,760.00	Donatorë	0.00
Shpenzimet e qirasë për veturat në Serbi	12,000.00	Donatorë	12,000.00	Donatorë	0.00
Ri-regjistrimi i 25 veturave në Kosovë	4,713.00	BKK	4,713.00	Donatorë	0.00
Shpenzimet e sigurimit për veturat me tabela të UNOPS-it	6,702.00	BKK	6,702.00	Donatorë	0.00
Shpenzimet tjera të transp.(ndërrimi i zyrave, 2 generatorë)	25,000.00	BKK	25,000.00	Donatorë	0.00
Shërbimet Komunale	105,000.00		105,000.00		0.00
Shërbimet Komunale në Kosovë	105,000.00	BKK	105,000.00	BKK	0.00
Investimet kapitale	37,700.00				0.00
Investimet kapitale	37,700.00	Amerika	37,700.00	Amerika	0.00
Aktivitetet e informimit publik	58,450.00		0.00		58,450.00
Aktivitetet e informimit publik	58,450.00	Belgjika		Belgjika	58,450.00
Fondi i përgjithshëm i BKK-së	1,153,082.00		1,043,107.00		109,975.00
Fondi i përgjithshëm i donatorëve	2,388,325.89		1,967,230.83		421,095.06
Gjithsejt	3,541,407.89		3,010,337.83		531,070.06

Aneksi E – Pasqyra e shpenzimeve të buxhetit të AKP-së për vitin 2009

Agjencia Kosovare e Pronës - Pasqyra Buxhetore për vitin 2009

Kodi Enonomik	BKK	A		B	C	D=A-C	C/A përkundër asaj të buxhetuar
		Ndarjet	Alokimet				
Totali i AKP		1,043,107.00	1,043,107.00	928,768.88	114,338.12	89.04%	
11100	Pagat dhe mëditjet	236,107.00	236,107.00	219,875.36	16,231.64	93.13%	
13000	Mallrat dhe shërbimet	702,000.00	702,000.00	638,831.76	63,168.24	91.00%	
13200	Shërbimet Komunale	105,000.00	105,000.00	70,061.76	34,938.24	66.73%	
22	Të ardhurat vetanake të bartura nga viti 2008	17,146.92	17,146.92	8,221.07	8,925.85	47.94%	

Kodi Ekonomik	Donatorët	A	B	C	D=A-C	C/A (%) e shpenzuar përkundër asaj të buxhetuar
		Ndarjet	Alokimet	Shpenzimet	Të papaguara	
Totali i AKP		2,918,897.74	2,918,897.74	2,219,851.55	530,294.40	76.05%
11100	Pagat dhe Mëditjet	1,733,447.98	1,733,447.98	1,215,616.73	369,981.49	70.13%
13000	Mallrat dhe shërbimet	1,185,449.76	1,185,449.76	1,004,234.82	160,312.91	84.71%
13200	Shërbimet Komunale	0.00	0.00	0.00	0.00	

Fondet e mbetura nga kontributet e mëhershme të donatori

Qeveria Kanadeze	9,380.00
Qeveria Gjermane	17,900.00
Sllovenia	1,884.00
Zvicra (cohre)	541.00
Gjithsej:	29,705.00

Aneksi F – Pronat nën administrimin e AKP-së sipas regjioneve dhe komunave


Komuna	Të iniciuara nga AKP-ja	ME KËRKESËN E PARAQITËSIT TË KËRKESËS:
	Gjithsej: 960	Gjithsej: 3137
MITROVICË	190	933
Leposaviq	0	0
Mitrovicë	65	791
Skënderaj	2	31
Vushtri	123	84
Zubin Potok	0	10
Zveçan	0	17
GJILAN	231	267
Gjilan	81	23
Kamenicë	43	6
Kaçanik	0	16
Novo bërdë	0	8
Shtërpçë	0	2
Ferizaj	10	169
Viti	97	43
PEJË	229	1207
Gjakovë	18	335
Deçan	39	262
Klinë	20	55
Istog	25	120
Pejë	127	435
PRISHTINË	257	405
Glllogoc	0	2
F.Kosovë	77	32
Lipjan	13	27
Obiliq	39	95
Podujevë	0	30
Prishtinë	112	211
Shtime	16	8
PRIZREN	53	325
Dragash	0	6
Malishevë	0	0
Rahovec	0	45
Prizren	51	210
Suharekë	2	64

Aneksi G – Organogrami i AKP-së

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AKP-SË



Kosovo Property Agency



**Selia**

Perandori Justinian 5, Qyteza Pejton, Prishtinë,
tel.038/249-918, fax.038/249-919.

Prishtinë

Rexhep Luci 2,
tel.038/225-473, fax.038/244-854.
Graçanicë
Vidovdanit pn.

Prizren

William Walker pn Prizren (në zyrën e EULEX-it),
tel. 029/231-429 dhe 029/231-469.

Gjilan

Lidhja e Prizrenit 114,
tel.0280/320-289, fax.0280/324-067.

Mitrovicë

Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës),
tel.028/530-136, fax.028/530-139
Pjesa Veriore e Mitrovicës
Ndërtesa e AKM-së, Dhoma nr.18,
Kompleksi i Stacionit Verior të UNMIK-ut
tel: 063/197-6470

Pejë

Mbretëresha Teuta 8,
tel.039/431-668, fax.039/432-970

Podgoricë

Crnogorskih Serdara bb
tel.020/624-216; 081/623-744

Shkup

Vihnicka 10 (ndërtesa e CDRIM) kati i parë
tel. +389 71 886 564